

LEXMARK
LEGAL

KENI NEVOJË PËR KËSHILLA TË EKSPERTËVE PËR
IMIGRACIONIN NË MB? MOS KËRKONI MË TEJ!

EKIPI YNË I AVOKATËVE ME PËRVOJË TË IMIGRACIONIT ËSHTË I
SPECIALIZUAR NË:

- APLIKIMET PËR VIZË
- VENDBANIM TË PËRHERSHËM
- SHTETËSIA
- RASTET E AZILIT
- APELET PËR DËBIM

NE JEMI KËTU PËR T'JU UDHËHEQUR NË ÇDO HAP
TË RRUGËS. SUKSESI JUAJ NË EMIGRACION
ËSHTË MISIONI YNË!

KONTAKTONI LEXMARK LEGAL SOT PËR NJË TË ARDHME MË TË
NDRITSHME NË MB. PARTNERI JUAJ I BESUAR I IMIGRACIONIT!

ANA: 07435119343 Office: 0208 090 2488
ALDO: 07494181220
SANTJOLA: 07742877853

The Winning Box, Aquis House,
27-37 Station Road, Hayes, UB3
4DX



The Albanian

Gëzuar Vitin e Ri 2024!

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The Albanian newspaper in London

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929

**THE ALBANIAN**www.thealbanian.co.uk**PETRIT KUÇANA**

Në dy muaj, dy shqiptarë janë vetvlarë në Britani dhe mjerisht, asnjë reagim të vetëm nuk kemi parë nga autoritetet shqiptare.

A mund të kishte lajm më tragjik se ky për një komunitet, apo imazh më të përçudnuar për një shtet? Heshtja e autoriteteve shqiptare

duket se do të vazhdojë edhe në këto pak ditë të mbetura të 2023. E 2023 nuk mundi të shërojë imazhin e përçudnuar shqiptar në median britanike dhe jo vetëm (vazhdojmë të mbetemi komuniteti me numrin më të lartë të të dënuarve në burgjet britanike).

Megjithatë Shqipëria u bë i vetmi vend që nënshkroi marrëveshje me Britaninë për riatdhesimin, ku besohet se të paktën 5 000 shqiptarë janë riatdhesuar gjatë këtij viti.

Me një përlllogaritje të thjeshtë nga 13 mijë ë kanë ardhur vetëm vitin e kaluar, i bie që 8 000 janë akoma në pritje të kthimit apo siç thuhet në të zezën.

Pra vetëm ata të vitit të kaluar... po të viteve të mëparshme?...

A janë potencial i mundshëm i krimit?

Çfarë realisht ndodh me këta jetimë, që shteti i tyre nuk e di as ku janë dhe çdo vizitë e autoriteteve shqiptare në Londër, nuk adreson thujse asnjë nga pikëpyetjet për shtetasit shqiptarë, qoftë edhe si detyrim kushtetues (kujtojmë nenin 8 të kushtetutës).

Po me ata 5 000 të kthyerit a është kujdesur njeri?

A ka patur një program ri-integrimit apo ndihme nga autoritetet shqiptare?

A mund të kthehen ata në kontigjentin krimi, kur gjenden në kushtet e mbijetesës apo kur janë të zhytur në borxhe?

GËZUAR 2024!

Autoritetet shqiptare dështuan të bindin autoritetet britanike për punësimin sezonal të shqiptarëve apo liberalizimin e vizave të punës.

Thjesht kemi parë një marrëveshje riatdhesimi si dhe për të burgosurit. (Sigurisht që ka qenë shokim për autoritetet britanike ndërsa kanë mësuar se në burgjet shqiptare kërcet pushka, dhe një ndër të burgosurit e kthyer është ekzekutuar...) Për të disatën herë rishtrohet pyetja nëse Shqipëria është një vend i sigurt...

Nga ana tjetër 2023 shënoi edhe një shëmti të radhës. Në Tiranë u mbajt i ashtuquajturit Samit III i Diasporës. Shumëçka u tha përveç diasporës dhe të drejtës së shqiptarëve për të votuar në vendet ku ndodhen, si çdo qytetar tjetër i ra-

jonit dhe më gjerë.

Të gjitha gjasat janë që as në zgjedhjet e tjera diaspora shqiptare nuk do të votojë.

Qeveria shqiptare nuk e sheh të arsyeshme as regjistrimin e diasporës, madje gjithçkaja përmbledhet në qarkun e shkurtër të zvetnimit të demokracisë, ku duket se vetëm diaspora mund të jetë ai momenti kyç, i shpëtimit të asaj që ka mbetur.

Megjithatë atmosferat e festave të fundvitit sjell edhe shpresën, të paktën shpresën, bashkë me urimin e përmotshëm.

Gëzuar 2024!**AVOKATET E EMIGRACIONIT
PËR SHQIPTARËT NË UK****HA** Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA



**Imperium
Chambers**

Tel: 0207 242 3488

**Address: 2 Selkirk Road,
London SW17 0ES**

Email: enquiries@imperiumchambers.co.uk

Website: www.imperiumchambers.co.uk

YouTube: The Immigration Barrister

**A JENI MARTUAR PAS DATËS
31 DHJETOR 2020 DHE JU
ËSHTË REFUZUAR APLIKIMI
I EU SETTLEMENT SCHEME
(EUSS)?**

**DONI TË APELONI ÇESHTJEN
TUAJ NË SHKALLËN E PARË
APO TË DYTË TË AELIT?**



**ME NJË GARANCI SUKSESI TË LARTË NË TË GJITHË APELET BARISTERËT TANË TË KUALIFIKUAR
DHE ME EKSPERIENCË E NDJEKIN ÇESHTJEN TUAJ NGA FILLIMI NË FUND**

SHERBIMET QE OFROJME NE ÇESHTJET E EMIGRACIONIT PERFSHIJNE

Human Rights

Judicial Review

Appeals

(we have in house barristers)

Fresh claims

Asylum

Overstayers

Stateless

Detention & Bail

EEA family permit

EEA Permanent Residence

Indefinite Leave to Remain (ILR)

Nationality

Spouse Visa

Visitor Visa

Dependent children

Student,

Work & Entrepreneur Visa

Jemi te specializuar ne aplikimet per nderrimin
e shtetesise nga **Kosovar** ne **Shqiptar**

Per me shume informacion kontaktoni Adelen

Fully accredited by the
Bar Standard Board



**BAR
STANDARDS
BOARD**

Imperium Chambers

4.8 ★★★★★ (141) ⓘ

Lawyer in London, England · [Open](#)

Mob:

07901181592



ARBEN MANAJ

Hetimi për pandeminë e COVID-it, që po kryhet në Britani, ku janë duke u thirrur gjithë aktorët kryesorë që u morën me përballimin dhe menxhimin e asaj situatë, po merr trajtat e një telenovele, me nota të theksuara qesharake, ç'ka ka bërë që opinion publik, politik dhe mediatik, të ngrejë vetullat në shenjë mosbesimi dhe shock-u për çfarë ka dal nga goja e të marrëve në pyetje.

Fillimisht, ishte ish-kryeministri Boris Johnson ndër "bishat" e politikës, që dha dëshmi, i njohur gjerësisht si "pinoku" i politikës britanike, për shkak të moskonsistencës dhe natyrës së vërtetuar gënjeshtare të prononcimeve të tij, kur deklaroi se ai kishte humbur telefonin e tij celular,

MERRET NË PYETJE RISHI SUNAK/ HETIMI SE SI QEVERIA E MENAXHOI KRIZËN E PANDEMISË SË COVID

kur e pyetën, nëse i kishte në WhatsApp komunikimet me pjesëtarë të tjerë të rëndësishëm të kabinetit të tij qeveritar.

Pas tij i erdhi radha njeriut të 225 më të pasur në Britani, kryeministrit aktual Rishi Sunak, i cili në atë botë, ishte Ministri i Financave të qeverisë së Boris Johnson, njërit nga pasuesit e tij në këtë post.

Edhe Rishi Sunak njësoj si ish-bosi i tij, ka deklaruar se ai nuk i ka më mesazhet e tij në këtë platformë, pasi ka ndryshuar disa herë telefonat celularë që nga ajo kohë dhe nuk është se ishte ndonjë përdorues profili i WhatsApp-it.

Në rastin e Boris Johnson që ka humbur celularin, duket në rastin më të mirë, si një aksident apo një rast fatkeq, ndërsa në rastin e kryeministrit të sotëm më shumë po duket si konspiracion. Gjithçka po duket dhe tingëllon si telenovelë.

E nëse do duhet t'i shkohet deri në



fund këtij hetimi dhe të zbulohet e vërteta e komunikimeve mes zyrtareve më të lartë të kabinetit qeveritar britanik, komunikimet në WhatsApp edhe nëse telefoni humbet

apo ndërrohen numrat, kjo gjë është shumë e lehtë dhe këto komunikime sërish janë të rikuperueshme teknikisht nga operatorët telefonik, siç veprojnë institucionet ligjzbatuese

britanike kur hetojnë për krimin e organizuar dhe jo vetëm, një praktikë dhe të dhëna që përdoren rëndom nëpër gjykatat britanike si prova materiale në proceset gjyqësore.

HA
HARIS ALI SOLICITORS



KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

LEXMARK LEGAL

EKSPERTËT TUAJ TË BESUAR NË LIGJIN E
EMIGRACIONIT

A PO KËRKONI NDIHMË PROFESIONALE PËR ÇËSHTJET E EMIGRACIONIT?

Mos kërkoni më tej! Lexmark Legal është ekipi juaj i kërkuar i avokatëve ekspertë të imigracionit në Londër, të përkushtuar për të ofruar zgjidhje ligjore të nivelit të lartë të përshtatura për nevojat tuaja.



PSE TË ZGJIDHNI LEXMARK LEGAL?

- Profesionistë me përvojë të imigracionit
- Zgjidhje ligjore të personalizuar
- Ekspertizë e shumëanshme
- Përkushtuar për suksesin tuaj
- Qasje e dhembshur dhe e kujdeshme

Gati për të ndërmarrë hapin e parë drejt zgjidhjes së shqetësimeve tuaja ligjore? Kontaktoni avokatët e imigracionit ligjor të Lexmark dhe na lini të jemi partneri juaj ligjor i besuar.


CONTACT US

ANA: 07435119343

ALDO: 07494181220

SANTJOLA: 07742877853

OFFICE: 0208 090 2488

 The Winning Box, Aquis House, 27-37 Station Road, Hayes, UB3 4DX

SHËRBIME TË REJA:

1. Mbështetja e Legjislacionit Civil:

Lundrimi përmes legjislacionit civil mund të jetë kompleks, por mos u shqetësoni! Profesionistët tanë të kualifikuar ligjorë janë këtu për t'ju udhëhequr në çështje të ndryshme të së drejtës civile. Nga mosmarrëveshjet e kontratave të drejtat pronësore, ne ju kemi mbuluar me këshilla dhe përfaqësim gjithëpërfshirës.

2. Ndihmë e dhembshur për të drejtën e familjes:

Ne i kuptojmë ndjeshmëritë e përfshira në çështjet e së drejtës familjare. Qoftë divorci, kujdestaria e fëmijës ose birësimi, ekipi ynë empatik është i përkushtuar për t'i zgjidhur çështjet familjare me kujdes, duke siguruar rezultatet më të mira të mundshme për ju dhe të dashurit tuaj.

3. Shërbime të fuqishme të mbrojtjes kriminale:

Kur përballeni me akuza penale, të kesh një mbrojtje të fortë ligjore është thelbësore. Avokatët tanë me përvojë janë njohës të mirë të ligjit penal dhe të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat tuaja. Nga konsultimet ligjore të përfaqësimi në sallën e gjyqit, ne jemi këtu për të luftuar për drejtësinë tuaj.

PLANI I REDUKTIMIT TË EMIGRACIONIT NGA QEVERIA BRITANIKE

ANXHELA SEJDINI
ASHTON ROSS LAW

Për vite me radhë, qeveria konservatore e Mbretërisë së Bashkuar është përpjekur të frenojë migrimin. Nga planet e saj të dështuara për të dërguar azilkërkues në Rwanda deri tek rritja e tarifave shtesë të emigracionit dhe tarifave të Home Office, lufta kundër emigracionit ka qenë e vazhdueshme dhe brutale.

Sulmi i fundit i qeverisë synon emigrantët e ligjshëm, veçanërisht personat me vizë pune, bashkëshortët e tyre dhe vartësit e disa aplikantëve. Rregullat e reja,

të cilat hyjnë në fuqi në Janar 2024, rrisin ndjeshëm kriteret financiare si për vizat e bashkëshortëve ashtu edhe për rrugët e personat me vizë pune. Në pranverën e vitit 2024, kriteri minimal i të ardhurave për vizën e punëtorëve të kualifikuar dhe kriteri minimal i pagës për vizën familjare do të rritet në £38,700 në vit. Më parë, kriteri minimal i pagës së vizës së punës ishte £26,200 dhe kriteri minimal i vizës familjare ishte £18,600.

Përveç këtyre, rregullat vendosin kufizime të mëtejshme për personat në ngarkim që punëtorët dhe studentët mund të sjellin në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe shkurtojnë listën e profesioneve të rralla. Për më tepër, tarifa shtesë për NHS e emigrantëve do të rritet

gjithashtu më tej në Janar 2024 në £1,035 për aplikant, e pagueshme në vit për kohëzgjatjen e vizës. Aplikantët për viza të Sponsored Care Visas nuk do të mund të sjellin më asnjë vartës dhe/ose familje.

Kur kriza e kostos së jetesës është në kulmin e saj më të keq dhe të ardhurat mesatare publike mbeten shumë më të ulëta se të ardhurat minimale që kërkohen për vizat e përmendura më lartë, kërkesat e reja janë vërtet tronditëse dhe tashmë po ngrihen pyetje operationale se sa të realizueshme janë kërkesat e reja.

Nëse jeni në Mbretërinë e Bashkuar ose planifikoni të hyni në Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet ndonjë prej vizave dhe/ose rrugëve të mësipërme, ju rekomandojmë



që të aplikoni sa më shpejt të jetë e mundur përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi të plotë.

Në rast se keni nevojë për të disku-

tuar çështjen tuaj në më shumë detaje me anë të një konsulte mund të kontaktoni Anxhelën në

07578931363

“NA E MORI NË KTHESË ITALIA”, BRITANIA E BEFASUAR NGA MARRËVESHJA ME SHQIPËRINË PËR AZILKËRKUESIT!

Britania e Madhe mbeti pa fjalë nga lajmi se Italia kishte nënshkruar me Shqipërinë një marrëveshje të stilit të Ruandës për emigrantët e kapur në det, ide kjo të cilën Londra vetë e ka hedhur prej kohësh.

Në fillim të këtij viti, kujton Daily Telegraph, ministrat britanikë injektuan energji të re tek përpjekjet e një ujdje me Tiranën, sipas të cilës ajo do të pranonte emigrantët e ndaluar në kanalën e La Manshit në mënyrë që kërkesat e tyre për azil të shqyrtoheshin në vendin ballkanik thuhet në shkrim. Por entuziazmi i tyre u fashit kur si Foreign Office, ashtu edhe ambasada britanike në Tiranë i këshilluan se kjo do të përbente një “vijë e kuqe” për shqiptarët. Megjithatë, qeveria britanike u befasua kur Roma zbuloi marrëveshjen e saj me Shqipërinë, në bazë të të cilit vendi do të pranonte azilkërkuesit që zbrakonin në brigjet e saj.

“Kjo ishte e papritur për Foreign Office, pavarësisht se dihet që Italia ka një marrëdhënie të jashtëzakonshme me Shqipërinë për arsye historike”, tha një burim i cituar nga Telegraph.

Një zyrtar qeveritar pohoi nga ana



tjetër po për të njëjtën media përcolli pakënaqësinë me veprimin e italianëve, duke nënvizuar se ky përbën një kthim prapa për planet alternative të Londrës, e cila i kishte lënë mënjanë sakaq bisedimet me vendet e tjera. Gjatë takimit në Romë këtë fundjavë me kryeministren italiane Giorgia

Meloni dhe homologun britanik Rishi Sunak, shefi i ekzekutivit Edi Rama, pohoi se disa vende të tjera europiane kishin kërkuar një marrëveshje të ngjashme që do t'u lejonte atyre të dërgonin emigrantë në Shqipëri.

“Por ne thamë jo,” theksoi ai,

duke shtuar se Italia përbën një rast të veçantë për shkak të lidhjeve të ngushta historike dhe kulturore mes dy vendeve. Përpjekjet e Anglisë për të nisur fluturimet e dëbimit të emigrantëve të paligjshëm drejt Ruandës kanë vazhduar që nga qershori 2022, por janë ngrirë aktualisht, teksa në

nëntor Gjykata e Lartë e Mbretërisë së Bashkuar doli me vendimin se plani ishte i paligjshëm për shkak të rrezikut që azilkërkuesit e dërguar në vendin afrikan të ktheheshin në vendet e tyre të origjinës, ku mund të përballeshin me persekutin. tch



ASHTON ROSS LAW

EMIGRACIONI

Çdo çështje është unike dhe për kete arsye ne kemi krijuar një reputacion për ofrimin e këshillave dhe shërbimeve të emigracionit më të shkëlqyer.

Ne kemi një shkallë të lartë suksesi në çështjet që marrim përsipër. Llojet e çështjeve që marrim përsipër janë:

- Immigration Appeals
- Judicial Review
- Administrative Review – rishqyrtim vendimi
- British Citizenship deprivation
- Indefinite Leave to Remain
- Family and Dependant related visa applications for children, spouses and fiancés
- Dependant visa

CALL NOW

T: 075 7893 1363

1 Quality Court, London,
WC2A 1HR

www.ashtonrosslaw.com



Për çdo pyetje në lidhje me emigracionin, kontaktoni Anxhelën në numrin e telefonit: 07578931363.

HUMAN RIGHTS

- EU Settlement Scheme
- Detention & Bail
- Private and Family life
- Naturalisation
- Asylum
- Visa Extensions
- Sponsorship licence
- Switching Visas

Çështje familjare

- Divorce
- Adoption
- Child Arrangement Orders
- Parental Responsibility
- Orders
- Premarital agreements
- Postmarital agreements



MIGRIMI "THAN" QARQET, POPULLSIA E 9 RRETHEVE IKU DREJT TIRANËS DHE DURRËSIT MË 2022

Shumica e qarqeve të vendit 9 prej 12 gjithsej janë duke vuajtur rënien e popullsisë edhe nga emigrimi i brendshëm, përveç ikjes jashtë vendit dhe rënies së lindjeve.

INSTAT raporto i se në vitin 2022 migrimi brenda Shqipërisë ka një ndikim të rëndësishëm në popullsinë e njësive administrative.

Në vitin 2022, në nivel qarku, vetëm Tirana, Durrësi dhe Vlora kishin një migrim të brendshëm neto pozitiv (më shumë të ardhur se sa të larguar), respektivisht me 7.366 Tirana, 1.182 Durrësi dhe 239 Vlora (të ardhur më shumë se sa të larguar).

Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, të gjitha qarqet e tjera (Berati, Dibra, Elbasani, Fieri, Gjirokastra, Korça, Kukësi, Lezha, Shkodra,) kanë pasur migracion të brendshëm neto negativ gjatë vitit 2022.

Në veçanti qarqet e Dibrës dhe Elbasanit me -1.822 dhe -1.283 respektivisht.

Një tregues tjetër, koeficienti bruto i migracionit të brendshëm neto tregon ndikimin që ka migracioni i brendshëm në popullsinë e qarqeve të veçanta. Tirana, Durrësi dhe Vlora ishin qarqet e vetme me koeficient bruto të migrimit të brendshëm neto

pozitiv, me një shtesë prej 8,0 për Tiranën dhe 4,1 për Durrësin dhe 1,3 për Vlorën (persona për një mijë banorë) respektivisht.

Qarqet e Dibrës dhe Gjirokastrës kishin nivelet më të ulëta të koeficientit bruto të migracionit të brendshëm neto, përkatësisht me -16,9 dhe -12,1 i ndjekur nga qarku i Kukësit me -10,4 (persona për një mijë banorë) respektivisht.

Në vitin 2022, bashkia me migracionin e brendshëm neto më të lartë ishte Tirana, me një vlerë prej 6.004 të ardhur më shumë se sa të larguar, ndërsa bashkia me migracionin e brendshëm neto më të ulët ishte Dibra, me 744 të larguar më shumë se të ardhur.

Popullsia e Shqipërisë ka ardhur duke u zvogëluar që nga viti 2001, megjithëse jo të gjitha qarqet kanë ndjekur këtë priorje.

Popullsia mesatare e Shqipërisë u pakësua nga 2.811.666 banorë më 2021 në 2.777.689 banorë në 2022. Në vitin 2022, qarku me popullsinë mesatare më të madhe në Shqipëri ishte i Tirana me 922.386 banorë, i



ndjekur nga qarku i Durrësit me 290.561 banorë. Në të njëjtën kohë, dy qarqet me popullsinë mesatare më të vogël në vitin 2022 ishin Gjirokastra dhe Kukësi, respektivisht me 54.296 dhe 72.133 banorë.

Gjatë vitit 2022, vetëm popullsia e qarku të Tiranës është rritur, ndërsa të gjitha qarqet e tjera kishin një normë negative të rritjes së popullsisë.

Qarku i Tiranës ka pasur nivelin më të lartë të rritjes së popullsisë mesa-

tare gjatë vitit 2022, pasi u rrit me 0,7% krahasuar me vitin 2021. Nga ana tjetër, qarku me normën më të ulët të rritjes së popullsisë mesatare ishte ai i Gjirokastrës, me -4,2%, gjatë vitit 2022./ Monitor

Apollonia Transport

TRANSPORT MALLRASH ANGLI - SHQIPERI SHQIPERI - ANGLI

SHQIPËRI

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh

BRITANI

Londër - Birmingham
Manchester - Leeds -Luton

NA KONTAKTONI

UK: 00447429200952
AL: 00355682948843
AL:00355694031009

TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI

+44 7741 588799 **+355 67 728 2828**

SHQIPËRI

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh

ANGLI

- Kuçovë
- Kozare
- Ura Vaigurore
- Korçe
- Pogradec
- Përrenjas
- Hollisht
- Peqin
- Rrogazhine
- Kavajë
- Durrës

Londër
Manchester
Sheffield
Leeds
Birmingham
Coventry
Luton
Oxford
Northampton

Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë

Ju Faleminderit qe na besoni!

Avokatia Shqiptare

Klea M.

**KONTAKTONI
KLEA M.**

0798 631 527

PER KONSULT FALAS

ADVANTAGE SOLICITORS NE VERI TE LONDRES.

Advantage gjithmone ofron ndihme ne nje menyre profesionale, miqesore dhe te shpejte.

077 9863 1527

**252 Green Lanes,
Palmers Green N13 5TU**

Sherbimet Tona Jane:

- Visa, Sponsorship
- Neglizhenca Klinike
- E Drejta e Familjes
- Ligji i Emigracionit
- Lendim Personal
- Ligji Per Strehimin
- Ankesa Per Perfitime Te Mireqenjes
- Rikuperimi i Borxheve
- Ligji I Punesimit
- E Drejta Tregtare

**ADVANTAGE
SOLICITORS**

klea@advantagesolicitors.com www.advantagesolicitors.com

ARBEN MANAJ

Perpara disa muajsh, ne nje televizion te Tiranes, jam akuzuar publikisht se kisha qene bashkepunetor i ish-Sigurimit fameq te Shtetit. Nuk reagova menjehere publikisht, edhe pse dhimbja dhe frustrimi ishin te jashtezakonshem, per shkak te pafuqise per te vertetuar menjehere te kunderten.

I vetedijeshem per cmimin qe po paguaja publikisht dhe padrejtesisht permes njollosjes se figures time publike dhe imazhit personal dhe profesional, edhe pse e dija se derisa te dal e verteta, genjashtra ka bere xhiron e botes, sic edhe e beri, vendosa t'i drejtohem si te vetmit institucion shqiptar autoritar dhe kredibel, qe do te konfirmonte perfundimisht dhe pa ekuivok, nje pretendim te tille, pikerisht "Autoritetit Per Informim mbi Dokumentat e ish-Sigurimit te Shtetit", i cili keto dite me informon se;

"Bazuar ne dokumentacionin e disponueshem nga ana jone si dhe nga verifikimet e kryera bazuar ne vendimin e Autoritetit, qe percakton protokollin standard te kerkimit, per shtetasin Arben Ali Manaj nuk ekzistojne te dhena qe te kete qene ndonjehere i survejuar apo te kete dokumente per te ne arkivat e ish-Sigurimit et Shtetit, te kete qene bashkepunetor i ish-Sigurimit te Shtetit apo i

PËRSE UNË ARBEN MANAJ NUK MUND TË ISHA BASHKËPUNTOR I SIGURIMIT TË SHTETIT!



favorizuar i ish-Sigurimit te Shtetit.

PER KËTO ARSYE

Bazuar ne nenin 5, 19, 20, 12 e vijues te ligjit nr. 45/2015 "Per te Drejten e Informimit per Dokumentet e Ish-sigurimit te Shtetit te

Republikes Popullore Socialiste te Shqiperise", i ndryshuar, ligjit nr. 8480, date 27.5.1999 "Per Funkcionimin e Organeve Kolegjiale te Administrates Shteterore dhe Enteve Publike", Autoriteti per Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit et Shtetit,

VENDOSI

Te informoje shtetasin Arben Ali Manaj per sa kerkohet ne shkresen nr. 732 prot., date 18.04.2023, ku mbi bazen e dokumentacionit te disponueshem nga ana jone si dhe nga verifikimet e kryera bazuar ne vendimin e Autoritetit, qe percakton protokollin standard te kerkimit, nuk ekzistojne te dhena qe te kete qene ndonjehere i survejuar apo te kete dokumente per te ne arkivat e ish-Sigurimit te Shtetit, te kete qene bashkepunetor i ish-Sigurimit te Shtetit apo i favorizuar i ish-Sigurimit et Shtetit.

Kyvendim hyn ne fuqi menjehere."

Une Arben Manaj, nuk mund te isha bashkepunetor i ish-Sigurimit te Shtetit, qofte edhe per nje fakt shume te thjeshte dhe publik. Une isha dhe jam djali krenar i ish-Kryetarit te Parlamentit te Shqiperise, Ali Manaj, njeriut te trete ne rradhe ne hierarkine e shtetit komunist shqiptare, ashtu si edhe sot ne demokraci.

Dhe nisur nga menyra e funk-

sionimit te ish-Sherbimit Sekret shqiptar, Sigurimit te Shtetit, ai sherbim nuk rekrutonte njerzit e pushtetit te tij, por kundersharet politik per te mesuar mbi aktivitetin e tyre kunder atij shteti.

Nje arsye tjeter, eshte edhe fakti se une ne Shqiperi pas punes si analist per Marredheniet Nderkombetare ne RTVSH, kam qene edhe Korrespondent ne Tirane, i Agjensise amerikane te Lajmeve, Associated Press, e me pas nga 1993, si gazetar i BBC ne Londer per 19 vjet, dhe me siguri se keto institucione te SHBA dhe Britanise, permes kanalave te tyre te verifikimit te figures, do mund ta kene bere nje vetting dhe verifikim te se shkuars sime dhe cdo bashkepunim te mundshem hipotetik timin me ish-sherbimin sekret shqiptar fameq!

Ne mbyllje, me lejoni t'ju informoj se une kam instruktuar nje studio dhe avokatin me te specializuar ne Shqiperi, per kete shkelje te paligjshme te reputacionit tim, per te nisur cdo proces gjyqesor te nevojshem ndaj akuzuesit dhe mediave e portaleve qe publikuan nje akuze te tille, ne Shqiperi dhe Britani!

Në fillim të dhjetorit Rebeka Kaya po festonte pasi ajo dhe burri i saj kurd Baran më në fund arritën objektivin e tyre të kursimeve për t'u kualifikuar për një vizë britanike në mënyrë që çifti të mund të lëvizte nga Icmeler, Turqi në Britani.

Disa ditë më vonë, kryeministri Rishi Sunak rriti shumë që një britanik duhet të fitojë për të sponsorizuar një partner të huaj për t'u transferuar në Britani, duke rritur frikën e tyre se pragu i kursimeve do të kërcejë dhe vlerën e kursimeve personale.

Politika e re erdhi disa ditë pasi të dhënat zyrtare vendosën migracionin neto legal në Britani në një nivel rekord prej 745,000 në vitin 2022, duke bërë që qeveria të shpallë një sërë masash për ta bërë më të vështirë lëvizjen e njerëzve në vend.

Shqetësimet e publikut për nivelet e larta të migrimit kanë dominuar peizazhin politik të Britanisë për më shumë se një dekadë, duke luajtur një rol kyç në votën e vendit për t'u larguar nga Bashkimi Evropian dhe duke e shtyrë Sunak të përpiqet të dërgojë ata që mbërrijnë ilegalisht në Ruanda për të vepruar si një pengesë. Duke synuar ata që mbërrijnë me viza

"DASHURINË OSE VENDIN!", PLANET E SUNAK PËR ULJEN E MIGRACIONIT I VËNË PARA ZGJEDHJES BRITANIKET E MARTUARA ME TË HUAJ

bashkëshortore, rreth 65,000 në vitin që përfundon në shtator, qeveria ka dyfishuar pagën vjetore që një britanik duhet të fitojë për të sponsorizuar vizën e një partneri të huaj, në 38,700 paund (49,170 dollarë) nga 18,600 paund.

Sipas Observatorit të Migracionit në Universitetin e Oksfordit, gati 70% e punonjësve britanikë në Mbretërinë e Bashkuar nuk fitojnë mjaftueshëm për t'u kualifikuar për nivelin më të lartë në 2023-shin.

Ai tha se Britania kishte një nga kërkesat më të larta të të ardhurave në botë, pasi shumë vende të tjera i bazojnë nivelet e tyre rreth pagës minimale.

Për Kayas, ata kishin ndjekur një mënyrë alternative për të siguruar një vizë, duke krijuar kursime personale nga puna e Baranit në biznesin familjar në tregtinë e mikpritjes, kompaninë online të bizhuterive të Rebekës dhe paratë e trashëgimisë nga babai i saj.

Ata sapo kishin vendosur 62,500 paund të kërkuara në një llogari në Mbretërinë e Bashkuar, ku do të duhej të ishin për gjashtë muaj për të marrë një vizë.

Ndërsa qeveria nuk ka thënë nëse pragu i kursimeve do të rritet gjithashtu, avokatët e imigracionit këshillohen se duhet të presin rritjen. Politika e re prek dhe ripërtërimin e vizave

Politika e re, e cila do të hyjë në fuqi në muajin prill, është shpallur me shumë pak detaje, duke shkaktuar alarm jo vetëm tek çiftet që shpresojnë të lëvizin në Britani, por edhe tek ata tashmë të pranishëm që duhet të rinovojnë vizat.

Josephine Whitaker-Yilmaz, eksperte e politikave në shoqatën bamirëse të emigrantëve Praxis, tha se ndryshimi ishte "çuditërisht në kundërshtim me pretendimin e qeverisë për të qenë partia e familjeve".

Paige Ballmi, 29 vjeç, dhe bashkëshorti i saj Tom, 29 vjeç, i cili

është nga Shqipëria, kanë frikë se planet familjare do t'u kthehen përmby.

Sipas rregullave, një vizë e parë bashkëshortore varet nga të ardhurat e shtetasit britanik, por të ardhurat e kombinuara të një çifti do të merren parasysh për rinovimet e ardhshme të vizave.

Në rastin e tyre, Tom, duke fituar 32,000 paund si marangoz i vetëpunësuar, është ofruesi kryesor ndërsa Paige kujdeset për vajzën e tyre dyvjeçare.

Ai do të ketë të drejtë të aplikojë për leje të pacaktuar për të qëndruar deri në prill afati kur i skadon viza e tij e dytë bashkëshortore, por bashkëshortja ka frikë se ai mund të duhet të largohet nëse ata nuk plotësojnë kërkesën prej 38,700 paund.

"(Kjo) është krejtësisht e padrejtë për fëmijën tim", i tha ajo Reuters në shtëpinë e saj në Enfield, Londër. "Vajza ime ka të drejtë t'i ketë të dy

prindërit e saj këtu"

Në vetvete, një shtrëngim i rregullave bashkëshortore nuk ka gjasa të godasë ekonominë, por kritikët kanë paralajmëruar se disa nga ata në sistemin bashkëshortor erdhën fillimisht në Britani për diploma pasuniversitare, lloji i punonjësit të kualifikuar që qeveria duhet të dëshirojë të mbajë.

Alexandra Kimmons, 29 vjeç, shpresonte se do të jetonte në Britani me bashkëshortin e saj, Ben Fong, kur ai të përfundonte studimet në Shtetet e Bashkuara. Por duke fituar 35,000 paund në sektorin jofitimprurës, ajo tani po mendon t'i kërkojë familjes ndihmë për të marrë një punë shtesë ose të zhvendoset në Shtetet e Bashkuara."

"Pra këta po i thonë 2/3 të popullsisë së tyre ju nuk keni të drejtë të bini në dashuri me dikë që jeton jashtë Mbretërisë së Bashkuar?" ajo tha.

TCH

Shpresa Programme


Inspiring hope & change

**Shpresa Programme
uron përdoruesit e saj dhe
të gjithë shqiptarët në UK**



*Gëzuar Festat
e Fundvitit!*

**30 Avenons Rd, London E13 8HT
020 7511 1586**



ANDI BUSHATI

SPAK dhe kuvendi po bashkëpunojnë për ti dhënë fund procedurave për arrestimin e Berishës. Nga ana tjetër, nuk është më sekret, as mes gazetarëve, as mes politikanëve, se së paku njëri nga pjestarët e çiftit që drejton partinë e dytë më të madhe në opozitë, do të pësojë të njëjtin fat.

Ky rast i paprecedent, sipas disave, hap një faqe të re në historinë e këtij vendi. Ata shpallin plot besim dhe shpresë se, më në fund, ka mbërritur epoka e shumëpritur e fundit të pandëshkueshmërisë. Ata i gëzohen faktit se arritën, në të gjallë të tyre, të përjetojnë atë që dukej e paimagjueshme vetëm pak kohë më parë, pra që Saliu, Iliri, apo Monika të shkojnë para drejtësisë si të gjithë njerëzit e zakonshëm.

Në fakt, ëndërra për prokurorë apo gjyqtarë të pavarur që godasin edhe ministra, deputetë, apo kryebashkiakë të partisë në pushtet, pa kursyer aspak as ata të qeverisjeve të mëparshme është një fabul e bukur, në këtë vend të grabitur prej tre dekadash. Nëse ky ndëshkim i të gjitha palëve, zhvillohet me standarte të njëjta, duke përdorur të njëjtën masë dhe të njëjtën peshë për të gjithë, natyrisht që ai do të qe i mirëseardhur.

Por, fatkeqësisht, kjo tablo optimiste mund të shihet edhe nga një kënd shumë më i zymtë dhe më shqetësues. Pasi, nëse llogaridhënia e atyre që kanë qeverisur dje, mund të përbënte



një ogur shpresëdhënës për drejtësinë, goditja “en bloc” e krerëve të opozitës së sotme është një lajm i keq për demokracinë.

Duke e parë nga kjo optikë atë që po ndodh nuk dua të ndalem vetëm tek standartet e dyfishta të SPAK-ut, që po na tregon një histori sipas së cilës në kohën e Berishës vidhej me bekimin e shefit, ndërsa në atë të Ramës duke ia hedhur atij pas shpine. Nuk dua as ti rikthehem paradoksit të stërpërdorur se grabitës votash qenkëshin ata të LSI ose Beleri, dhe jo banda e organizuar e dosjeve të

A MUND TË KTHEHET SPAK NË VRASËS TË DEMOKRACISË?

lirisë po ngushtohen, kur pronarëve të mediave po i vihet tritol, kur zërat realisht kritikë janë mpakur deri në mjerim.

Nëse SPAK godet dikë nga çifti Meta, askush nuk mund të mos çojë nëpër mend tentativat që u bënë për të shkarkuar presidentin si shkelës të kushtetutës, pastaj daljen e beftë të dokumentave të “spionit”, pastaj hartimin e një projektligji që ish sigurim-sat duhen përjashtuar nga politika dhe më tej akoma, atë tjetrin, për të mos lënë partitë e kryesura nga ish bashkëpunëtorë, për të garuar në zgjedhje.

E njëjta fabul vlen dhe për Berishën. Kundër tij u lobua për ta shpallur non grata me metoda alla McGonigal. U ushtrua presion për ta nxjerrë jashtë parlamentit. Kjo ndau, përçau dhe sakatosi PD-në. E pavarësisht këtyre, ndonëse edhe zgjedhjet edhe matjet e opinionit, tregojnë se Berisha është shumicë dërrmuese në PD, pushteti po përdor disa palaço politikë dhe gjykatës kamikazë, për ti mbajtur peng vulën e përfaqësimit. Këto manovra pollën anomalinë e një opozite që nuk garoi dot normalisht në zgjedhjet e 14 majit, që u zhvesh

nga e drejta për të pasur komisionerë, numërues, financim publik, madje më absurdja edhe nga ajo për të pasur emrin e liderit të saj në fletën e votimit.

Pra, pavarësisht sa e pandershme, joparimore, e pa rinovuar apo e pa drejtë qoftë kjo opozitë, sado keq të jetë katandisur ajo, është një fakt i pamohueshëm se tashmë ekziston një projekt për eliminimin total të saj. Rastësi apo jo, SPAK-u rrezikon të bëjë në këtë proces rolin e xhelatit të gjyotinës që i jep fund një kalvari të gjatë. Ai me gjasë mund të mbyllë një përpjekje që Rama e nisi pa e përfunduar dot. E po të vazhdojmë me përkimet, e gjithë kjo filloi pasi kryeministri ngriti zërin në kongreset e partisë së tij, se durimi për arrestimin e Saliut po sosej dhe se gjithë Shqipëria e donte Metën në burg.

Tani që këto kërkesa po bëhen realitet shumëkush po gëzohet, qoftë nga ndjenja e revanshit, qoftë nga ajo e naivitetit, se në fund të fundit, gjithësesi, dikush po shkon pas hekurave. Por, duke “festuar” këtë ne nuk kemi luksin të harrojmë se ky mund të jetë finalizimi i planit për një sistem pa opozitë.

AUGUSTIN PALOKAJ

Zgjedhjet e së dielës në Serbi ishin të rëndësishme vetëm për Serbinë. Ato për vendet fqinje të Serbisë, përfshirë edhe Kosovën, nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë. Natyrisht se do të ishte e mirëseardhur që në Serbi të ketë një pushtet dhe pse jo edhe një opozitë, e cila do të ishte demokratike, e interesuar për pajtim me fqinjët dhe për stabilitet në rajon. Por një e tillë nuk ekziston dhe as nuk duket diku në horizont. Është krejt e kundërta.

Në Serbi janë në pushtet strukturat nga e kaluara, nga periudha e Slobodan Milosheviçit. Politikanët kryesorë janë Aleksandar Vuçiç dhe Ivica Daçiç. Ata i janë kthyer retorikës nacionaliste, nxitëse ndaj fqinjëve, sidomos ndaj Kosovës, Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës. Për më tepër në spotet zgjedhore të Partisë Socialiste të Serbisë glorifikohet haptas Slobodan Milosheviçi. Glorifikohen kriminelët e luftës, edhe ata të dënuar nga gjykatat ndërkombëtare. Dhe raportet me Kosovën përmenden kryesisht në kontekstin nacionalist se “nuk do ta japim Kosovën dhe Metohinë”.

Këto struktura në Serbi kanë mbështetje të madhe ndërkombëtare. Madje, është edhe paradoksale dhe fenomen se ato kanë mbështetje dhe nga Brukseli e Uashingtoni, edhe nga

Moska e Pekini, edhe nga Teherani e Sudani. E opozita në Serbi ndoshta ndryshon pak në stil, është pak më shumë demokratike, por nuk dallon shumë nga pushteti i Vuçiçit dhe Daçiçit sa u përket raporteve me fqinjët, sidomos me Kosovën. Prandaj as për dialogun e pafat të Brukselit, i cili gradualisht është para dështimit total, rezultati i zgjedhjeve të 17 dhjetorit nuk do të ketë ndonjë rëndësi të veçantë. Dialogu është shumë joserioz. Ai më nuk ka as parime e as vullnet politik nga palët që të jetë sukses. Vullneti politik mungon edhe nga ana e BE-së në cilësinë e lehtësuesit.

Qasjen e tillë të BE-së e ka shfrytëzuar Serbia për ta sjellë dialogun këtu ku është tani, në një fazë ku nuk e dimë a ka apo jo marrëveshje. Sepse kur njëra palë thotë se nuk ka marrëveshje, atëherë pak ka rëndësi se çfarë thotë lehtësuesi. E Serbia me gojë e më shkrim tash konfirmon se ajo nuk e konsideron se ka obligim të zbatojë pjesë të marrëveshjeve që asaj nuk i pëlqejnë, e nuk i pëlqen asnjë që ka sado pak rëndësi për Kosovën. Dhe përderisa Qeveria e Serbisë i jep goditje BE-së, duke refuzuar të pranojë obligimet, edhe opozita në Serbi është kundër asaj që BE-ja e quan Marrëveshje për rrugën drejt normalizimit të raporteve, apo siç quhet edhe

ZGJEDHJET NË SERBI, TË PARËNDËSISHME PËR RAPORTET ME KOSOVËN



“Plani franko-gjerman”.

Për më tepër, disa diplomatë në BE thonë se opozita e Serbisë ka një “iluzion total kur është fjala për Kosovën” dhe se iluzionet e opozitës janë më të mëdha sesa të Vuçiçit. Sepse, thonë këto burime, “Vuçiç nuk ka iluzione për Kosovën, ai i krijon ato te të tjerët në Serbi, por vetë nuk ka iluzione”. E për disa liderë të opozitës thonë se ata “bëhen kinsë besojnë se Kosova vërtet është pjesë e Serbisë dhe ata nuk do ta japin!”.

Gabimi i BE-së në qasjen e dialogut ka qenë se e kanë personalizuar shumë. Kanë menduar se duke llogaritur në qëndrimet e liderëve në peri-

udha të caktuara mund të arrihet sukcesi. Një herë thoshin se “me Hashim Thaçin e fortë në Kosovë dhe Boris Tadiçin e fortë në Serbi mund të arrihet sukcesi”. Pastaj thoshin se “me Thaçin e fortë në Kosovë dhe Daçiçin e fortë në Serbi mund të arrihet shumë”. E pastaj, “me Thaçin e fortë në Kosovë dhe Vuçiçin e fortë në Serbi mund të arrihet shumë”.

Dhe së fundi, kur në Kosovë fitoi Vetëvendosje, vetë lehtësuesit e BE-së thoshin se “tash kemi dy liderë me mandat të fuqishëm në të dyja anët dhe ata mund të bëjnë shumë në dialog”. Por në vend që të “bëhet shumë” dialogu ka shënuar ngecje, e në disa raste edhe prapaktim. Raportet mes

Kosovës dhe Serbisë janë më pak normale dhe ato janë në nivel të konfliktit pothuajse të hapur e jo vetëm verbal. Procesin e dialogut nuk e ka bërë joserioz Serbia, por Bashkimi Evropian.

Nëse sukcesi i dialogut do të varet nga Serbia, atëherë ai do të dështojë, sepse Serbia do ta shfrytëzojë secilin lëshim që i bën BE-ja. E lëshimet e BE-së ndaj Serbisë janë pafund, përfshirë edhe tash kur Serbia me shkrim bëri të qartë se nuk do të zbatojë obligimet kryesore nga marrëveshja. Pa marrë parasysh rezultatin e zgjedhjeve në Serbi, sjellja e saj në dialog nuk do të ndryshojë, sepse edhe opozita në Serbi është kundër Marrëveshjes franko-gjermane.

Kushdo që të jetë në pushtet në Serbi do të sillt njësoj ndaj Kosovës. Pos nëse BE-ja vërtet e merr vetveten seriozisht dhe rolin e saj në dialog dhe siguron që të mos mbetet pa pasoja Serbia, e cila refuzon normalizimin e raporteve me Kosovën. Ndërkohë Kosova dhe aleatët e saj duhet të sigurojnë që Serbia, edhe nëse do, të mos ketë mundësi ta sulmojë më dhe ta destabilizojë Kosovën. Siguria e Kosovës nuk duhet të varet nga vullneti i mirë i Serbisë. As nga niveli i demokracisë në Serbi. “Koha Ditore”

ANGLEZËT ME SYTË NGA NE “KUJT I DUHET RUANDA, KUR KEMI SHQIPËRINË!!!”

Ndërsa ngre një çadër për t'u mbrojtur nga shiu rrebesh, drejtori i portit të vogël të Shëngjinit afrohet pranë një hapësire me baltë pas kalatës dhe i shpjegon gazetarit britanik të The Times, se si ky territor do të ndihmojë në zgjidhjen e problemit të emigrantëve drejt Italisë.

“Ky është vendi ku italianët do të ndërtojnë qendrën e tyre të përpunimit të emigrantëve,” janë fjalët e Sandër Marashit për The Times, “ajo do të mbulojë mbi 3000 m2, por nuk do të ndikojë në aktivitetin e portit” thotë ai.

Marashi citohet edhe teksa përsërit për gazetarin britanik të njëjtat formula që dëgjohej nëpër komunikimet e kryeministrit Rama për mediat italiane. “Është kënaqësi për që ndihmojmë pasi kjo është ajo që bëjnë për njëri tjetrin partnerët evropianë”.

Me këto fjalë të Marashit nga Lezha nis shkrimi në të cilën britanikët shfaqin interes për një vend tjetër të depozitimit të emigrantëve afrikanë më pak problematik se Ruanda. Qeveria britanike e drejtuar nga Rishi Sunak ka hasur në vështirësi për marrëveshjen me Ruandën, pasi gjykata e rrëzoi paktin e parë të nënshkruar mes Rishi Sunak dhe Pol Kagame.

Në këtë situatë, kur shohin se Italia e ka gjetur “Ruandën” e saj për 36,000 emigrantë në vit gazetari britanik ngre pyetjen: kujt i duhet Ruanda kur kemi Shqipërinë?

The Times citon Belind Këlliçin si një zë opozitar. As ai nuk shprehet kundër thelbit të marrëveshjes, por citohet të flasë për mungesën e transparencës dhe arrogancën e Ramës.

Ndërkohë media britanike ka një seri citimesh që i aprovojnë prurjet e afrikanëve në Shqipëri.

Taulant Balla, ministri i brendshëm flet edhe ai si Sandër Marashi, duke



përsëritur automatikisht togfjalëshat e Edi Ramës. “Të jesh anëtar i Bashkimit Europian nuk është vetëm e dobishme, por edhe përgjegjësi” thotë Balla, që shprehet pozitiv për marrëveshjen.

Media britanike citon edhe kryebashkiakun e Lezhës, Pjerin Ndreu që është i bindur se 36 mijë emigrantë afrikanë në vit nuk do ta dëmtojnë reputacionin e plazheve aty pranë. Për këtë, Pjerin Ndreu merr shembullin e emigrantëve afganëve kur thotë se “Ata janë sjellë në mënyrë të shkëlqyer”.

A po negociohet një marrëveshje e dytë Rama-Sunak për emigrantët? Rama Meloni Sunak

Shkrimi i The Times vjen pas një vizite të Edi Ramës në Itali, ku ai pati një takim dhe një drekë pune me kryeministren e Italisë, Xhorxhia Meloni dhe me kryeministrin e Britanisë së Madhe, Rishi Sunak.

Ky i fundit e ka mbyllur një marrëveshje me leverdi me Ramën pak muaj më parë, kur qeveria jonë pranoi të riatdhësojë 1500 të dënuar shqiptarë nga burgjet britanike drejt Shqipërisë.

Të dënuarit shqiptarë kanë qenë një shqetësim në rritje i opinionit publik në Britaninë e Madhe, veçanërisht pas fushatës së Brexit, kur propaganda e disa partive të djathta u intensifikua. Por tani që shohin se si Italianët po na përdorin si “kosh” për të devijuar fluksin e refugjatëve afrikanë, britanikët po shohin një shans tjetër shpëtimi tek Shqipëria.

A do të kemi një marrëveshje tjetër Rama-Sunak për importimin e afrikanëve? Është herët të japësh një përgjigje. Nuk ka asgjë konkrete në tryezë, përveç një dreke pune në Itali, të shoqëruar me shkrimet e mediave britanike që e krahasojnë Shqipërinë me Ruandën.

Çfarë e pengon Ramën për një marrëveshje me Rishi Sunak?

Së pari, janë vetë pohimet e Ramës. Ai ka pranuar se ka pasur kërkesa edhe nga vende të tjera, për ta përdorur Shqipërinë si vend tranzit në procedurat e emigracionit. Por Rama ka deklaruar se një marrëveshje të tillë mund ta bëjë vetëm me italianët, si një popull me të cilin shqiptarët janë në borxh për shkak të pritjes që iu bë gjatë eksodit në vitet 90.

Çështja është që kryeministri i ka ngrënë edhe më parë fjalët e tij. Edhe një marrëveshje si kjo me Melonin, ai e kishte mohuar para selisë së Partisë Socialiste, kur shprehej se nuk do të pranonte që vendet e pasura t'i shkarkojnë emigrantët e tyre në Shqipëri. Dhe sërisht e bëri.

Në anën tjetër një vendim i Gjykatës Kushtetuese ka pak gjasa ta ndalë marrëveshjen me Melonin. Tashmë

ajo është përshëndetur edhe nga presidentja e Këshillit Europian, Ursula von der Leyen, ndërsa mediat italiane e kanë përgëzuar në kor.

Dihet se gjykatësit e drejtësisë së re nuk e mbajnë presionin e ndërkombëtarëve. Në anën tjetër, Rama ia një mirë pikat e dobëta. Jo më kot, kryeministri doli garant se nuk ka asgjë për t'u shqetësuar ndërsa fliste në Itali për marrëveshjen për refugjatët italianë.

“Gjykata Kushtetuese ka bërë detyrën e saj. Pezullimi i marrëveshjes është proces automatik para se të ratifikohet, është provë se unë nuk kontrolloj gjykatat. Por jam i bindur se marrëveshja nuk ka asgjë antikushtetuese” tha Rama duke folur në krah të dy kryeministrave Meloni dhe Sunak.

Agron Kola, 47 vjeç, në të majtë, shprehet se shumica e banorëve janë të shqetësuar për mbërritjen e emigrantëve meshkuj afrikanë Agron Kola, 47 vjeç, në të majtë, shprehet se banorët janë të shqetësuar për mbërritjen e emigrantëve meshkuj afrikanë

I vetmi zë kundër në shkrimin e The Times është ai i një prej banorëve të zonës pranë Gjadrit, që thotë atë që të tjerët vetëm e pëshpërisin. “Shumica e njerëzve nuk do të ta thonë këtë, por nuk i duan emigrantët këtu sepse kanë frikë se do të ketë vetëm burra. Kështu që ata janë të shqetësuar për gratë dhe motrat e tyre,” citohet të thotë Agron Kola për gazetarin e The Times, që e prezanton si një fermer 47-vjeçar, që po pinte një gotë raki në kafenenë lokale./Lapsi.al

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:

020 7018 7929

073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

**Shtojini magjinë festave
të fundvitit me një website fantastik**



Adresa
30 Avenons Road
London, E13 8HT

Na kontaktoni
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

KRIZA SHPIRTËRORE E NËNË TEREZËS SIPAS SOCIOLOGUT GËZIM ALPION

Në korrik 2020, Bloomsbury Academic botoi në gjuhën angleze në Indi, Angli, Amerikë dhe Australi monografinë e Gëzim Alpiion Mother Teresa: The Saint and Her Nation (Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj). Edicioni i dytë i librit doli në 2022 and i treti më 10 Tetor 2023, që përkoi me përvjetorin e lindjes së autorit. Libri është botuar me kopertinë standarde, speciale dhe si eBook dhe recensuar në dhjetra revista shkencore dhe gazeta prestigjioze.

Në qershor të këtij viti, libri u vlerësua në Amerikë me ‘Çmimin e Ekselencës në Botime’ për vitin 2023 në kategorinë e ‘biografisë’ nga Shoqata e Botuesve Katolikë (Association of Catholic Publishers – ACP). Për këtë vepër Alpiion ka folur në Amerikë në Nju Jork dhe në universitetet e Harvardit dhe Georgetown. Në maj 2024, pas një turneu ligjëratash në Azi, do të jetë i ftuar në Tiranë. Dr Alpiion është diplomuar në Universitetet e Kajros dhe Durham. Aktualisht ai është Profesor i Asociuar i Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit në Mbretërinë e Bashkuar.


Që nga viti 2013 Alpiion po lobon për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, ndërsa në vitin 2014 filloi lobimin për shenjtërimin e Nënë Terezës. Në vitin 2019, Kryeministri i Shqipërisë i akordoi Alpiion çmimin ‘Ambasador i Kombit’. Ndërsa në 2021 ai u nderua nga Presidenti i Shqipërisë me ‘Medaljen Nënë Tereza’ në shenjë mirënjohje për “kontributin e tij të çmuar akademik në studimin e plotë të jetës dhe veprës së Shën Nënë Terezës, si dhe promovimin e saj si përfaqësuese e vlerave të kombit shqiptar”.

Libri i fundit i Alpiion tërhoqi menjëherë vëmendjen e studiuesve dhe mediave, përfshirë revistën së mirënjohur katolike THE TABLET në Londër, që e ftoi Alpiion para se të botohej libri të shkruante një artikull të posaçëm. Që monografia dhe shkrimi i Alpiion u vlerësuan nga revista duket edhe nga fakti që për kopertinën e datës 8 gusht 2020 u zgjodh portreti i Nënë Terezës i shoqëruara me këto fjalë: ‘Mother Teresa’s lost childhood – Gëzim Alpiion’ (Fëmijëria e humbur e Nënë Terezës).

Shkrimi i Alpiion në këtë revistë ngalli interesimin e studiuesve, përfshirë edhe të gazetarit amerikan David Van Biema, autori i librit ‘Mother Teresa: The Life and Works of a Modern Saint’ (Nënë Tereza: Jeta dhe Veprat e Një Shenjtores Moderne). Van Biema ishte kryeredaktori i fesë në revistën TIME nga 1998-2008.

Në mesazhin që Van Biema i dërgoi Alpiion, po më 8 gusht 2020, theksoi se ai e kishte lexuar shkrimin e tij në THE TABLET “me shumë interes”, dhe se në bazë të tij kishte konkluduar se libri i ri i Alpiion “duket si kontributi i parë madhor prej disa kohësh në literaturën e besueshme” rreth jetës së Nënë Terezës. Në të njëjtin mesazh, Van Biema e ftoi Alpiion për të zhvilluar një intervistë.

Intervista e parë që Van Biema zhvilloi me Alpiion në gusht 2020 u pasua nga 5 intervista të tjera në Zoom, dhjetra telefonata e qindra emaile gjatë një periudhe dy vjeçare. Gjatë kësaj kohe, Van Biema u njoh me të gjithë librat dhe studimet e Alpiion në revista shkencore dhe ndoqi ligjëratat e tij në Zoom me audiencën në Nju Delhi, Londër dhe Melburn. Van Biema gjithashtu komunikoi edhe me disa studiues që kanë shkruar për monografinë e Alpiion Mother Teresa: Saint or



Celebrity? (Nënë Tereza: Shenjtores apo e Famshme?), botuar në gjuhën angleze nga Routledge në vitin 2007 dhe italiane nga Salerno Editrice në 2008, si dhe recensues të librit të botuar nga Bloomsbury.

Van Biema i kushtoi studimeve prej dy dekadash të Alpiion për Nënë Terezën dhe veçanërisht librit të tij të fundit, shkrimin e titulluar ‘Shenjtores për çdo kohë’ (A Saint Forever), që revista LIFE në Nju Jorkut e përfshiu në numrin special të gushtit 2022 dedikuar shenjtores në përvjetorin e njëzetë e pestë të vdekjes.

Kjo është hera e parë që shkrimi i gazetarit Van Biema për veprën e Alpiion botohet i përkthyer në gjuhën shqipe.

LIFE Magazine

Shenjtores për çdo kohë David Van Biema,

Kërkimet e fundit zbulojnë një të vërtetë më të errët për historinë e Nënë Terezës. Por janë pikërisht shqetësimet e saj të hershme që mund të sigurojnë rezonancën e saj në një botë që po përballet me fatkeqësi të ngjashme. Askush nuk ka vënë në dyshim ndonjëherë se Gonxhe Agnes Bojaxhiu, Nënë Tereza, ishte një grua e jashtëzakonshme. Një studim i ri skrupuloz, që përqendrohet në vitet e saj të trazuarat të formimit, dëshmon se ajo ishte edhe më e veçantë nga sa mendonim.

Jeta e gruas se re ishte e mbushur me ankth dhe humbje. Kur ajo ishte dy vjeçe, armiqet e popullit të saj pushtuan Shkupin, qytetin e saj të lindjes, çarmatosën popullsinë, vranë qindra njerëz dhe vendosën një regjim armiqësor. Kur ajo ishte nëntë vjeçe, u dërgua për të gjetur një prift që t’i kryente ritet e fundit babait e saj të ri, i cili vdiq nga dhimbje të tmerrshme një ditë më vonë. Në moshën 12 vjeçe, jeta e saj shpesh ishte një rrëqe lotësh. Në atë kohë, përveç babait, ajo kishte humbur edhe shtatë njerëz shumë të afërt të familjes. Jeta e saj e hershme u dominua nga varrime njerëzish të dashur që humbën jetën për shkaqe në dukje palidhje.

Vitet e hershme të Nënë Terezës mund të kenë qenë shumë më të errëta se c’kemi ditur.

Në vitin 2011, Gëzim Alpiion, sociolog dhe studiues i Terezës në Universitetin Birminghamit në Britani mori një ftesë të rrallë për të takuar Rosa Çuni-Kuka, vajzën e motrës së bijësuar të Terezës. Siç tregon ai në librin e tij të fundit Mother Teresa: The Saint and Her Nation (Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj), Kuka i rrëfeu atij një kapitull të çuditshëm dhe të pazbuluar më parë të rinisë së shenjtores në qytetin ballkanik të Shkupit. Nga viti 1919 deri në vitin 1922, kur ajo ishte nga moshja 9 deri në 12 vjeçe, përveç babait, Tereza humbi edhe dajën e saj të vetëm, bashkeshorten e tij, pesë anëtare të familjes së dajës si dhe nënëdajën, njëri pas tjerit, për shkaqe të ndryshme që përfshinin meningjitin dhe ajo, që Kuka e përshkruan si “thyerje zemre”. E vetmja që mbijetoi nga ajo familja ishte e ëma e Kukës (Filomena), të cilën e bejësori familja Terezës.

Pas takimeve me Kukën në Melburn në vitin 2011 dhe 2013, Alpiion e shikoi të domosdoshme të vizitonte Shkupin përsëri. I lindur në Shqipëri, ai flet gjuhën e komunitetit të fëmijërisë së Shën Terezës, që ende përbën 21 për qind të popullsisë së qytetit. Për arsye që shpjegohen në libër, Alpiion nuk mundi të gjente dokumenta përse familja e Filomenës u shua pothuajse plotësisht. Por ai arriti në një teori të besueshme. Sipas tij, kur Gripi Spanjoll – që shkaktoi vdekjen e 50 milionë njerëzve në mbarë botën – mbërriti në Ballkan, nëse jo të gjithë, disa anëtarë të kësaj familje u bënë viktimat të epidemisë.

Alpiion thekson se kjo paradë e kobshme erdhi menjëherë pas humbjes më të madhe (të përmendur shpesh) që Tereza kishte përjetuar disa muaj më parë: vdekjen e papritur të babait, Nikollë Bojaxhiu, një biznesmen i shquar, ndoshta nga helmimi. Si pasojë, ai i kaloi momentet e fundit të jetës në agoni të tmerrshme.

Mund të thuhet se Tereza e rritur me siguri nuk do t’i kishte kushtuar vëmendje zbulimeve të Alpiion. “Familja ime ishte shumë e lumur”, ajo i tha një biografi. “Kam një vëlla dhe një motër por nuk dua të bisedoj për ta. E rëndësishme është të ndjekësh rrugën e Zotit.”

Shumica e kronikanëve kanë ndjekur këshillën e saj në lidhje me këtë, duke e portretizuar atë si një vajzë të devotshme, duke prekur vetëm shkurt vdekjen

e Nikollës, përpara se të trajtojnë momentin kur Tereza 18-vjeçare, duke vepruar sipas ‘thirrjes’ së Zotit, që ajo ndjeu për herë të parë në moshën 12-vjeçare, u nis drejt fatit të saj në Indi. Ky ishte vendi ku ajo filloi aktivitetin për të cilin njihet më shumë – përkujdesjen për më të vobektit dhe njerëzit e injoruar nga shoqëria. Megjithatë, magjepsja e sociologut britanik me vitet e saj të formimit vazhdoi. Përveç vdekjeve që Tereza përjetoi në vitet e hershme, Alpiion filloi të analizonte edhe stresin e vazhdueshëm që me siguri përjetonte çdo qytetar shqiptar në Shkup në atë kohë, dhe veçanërisht Tereza si fëmija e një drejtuesi të komunitetit si Nikolla. Gjatë kësaj periudhe, qyteti ishte vazhdimisht objekt sulmesh. Kur Tereza banonte në Shkup dhe pas largimit të saj, qyteti i lindjes përjetoi dy luftëra ballkanike, dy luftëra botërore, dhe tre pushtime të huaja: nga Franca, Bullgaria dhe Serbia. Milicët dhe ushtria serbe kryen mizori të shumta mbi popullatën shqiptarë para se ta vinin nën kontroll Shkupin dhe Maqedoninë.

Në dekadat në vijim, serbët përdorën represionin kulturor dhe shpërnguljen e detyruar për të realizuar planin e tyre për të zëvendësuar popullsinë shqiptare dhe turke me kolonë sllavë. Justin Elliott, student post doktorature pranë Fondacionin Shoah në Universitetin të Kalifornisë Jugore, që studion formimin e identitetit kombëtar shqiptar, thotë: “Të rriteshe si shqiptar në Shkup në atë kohë duhet të ketë qenë një stres i jashtëzakonshëm.”

Po që se dikush do t’i kujtonte Terezës së rritur realitetin e hidhur që kishte përjetuar në Shkup, ka shumë mundësi që ajo do ta trajtonte këtë temë si një devijim jo të mirëpritur. Fundja, përse duhet zbehur mesazhi i saj për të bërë punën e Zotit me histori të dhimbshme betejash për mbijetesë etnike që ajo i kishte lënë pas? Megjithatë, Alpiion beson se ‘trauma’ që përjetoi Tereza e re ishte farka ku u formua shenjtorja. “Stresi i vazhdueshëm që përjonte, të qenit dëshmitare e agonisë që i ati i saj kaloi në momentet e fundit dhe efekti që pati te ajo humbja e kaq shumë njerëzve të dashur nga epidemia spanjolle”, thekson Alpiion, “së bashku, bënë që te Tereza të zgjohej një dëshirë e thellë për të ndihmuar njerëzit për të cilët nuk kishte asnjë shpresë shpëtimi, për t’u ofruar atyre sado pak rehati, edhe pse në orët e fundit të jetës së tyre”. Tereza përjetoi ‘thirrjen e parë’ si misionare, thekson Alpiion, kur ishte 12 vjeçe në 1922, menjëherë pas humbjes së nënëdajës, që ishte edhe vdekja e fundit e dhimbshme në familje. Për Alpiion, këto trauma të hershme hodhën themelet e fenomenit më të dhimbshëm që ajo do të përjetonte më vonë: ‘natën e errët të shpirtit’, nga e cila ajo vuajti për 50 vjet. Kjo gjë u bë e njohur me zbulimin e letrave dhe shkrimeve të Terezës dy vite pas vdekjes së saj në 1997. Si rezultat i krizës shpirtërore, Tereza shpesh ndihej sikur Jezusi e kishte braktisur plotësisht. Perceptimi i saj i braktisjes hyjnore, sugjeron Alpiion, është pjesë e përjetimit të humbjes së babait të saj dhe pyetjes së vështirë pa përgjigje: “Ç’kuptim ka të jetosh kur njerëzit më të dashur zhidhen papritur?” Tereza e gjeti ‘rrugëzgjdhje’ në mi-

sionin e saj fetar. Megjithatë, ajo vazhdoi ta përjetonte rregullisht boshllëkun që lanë tek ajo vdekjet e lartpërmenduar nëpërmjet ‘natës së errët’ që, në rastin e saj, nuk u fashit kurrë.

Në pamje të parë, kjo lloj shkakësi (causality), që propozon Alpiion, mund të duket pavend. Që një tronditje e mbajtur kyçur që në fëmijëri mund të rishfaqet për të thyer – dhe/ose fisnikëruar – zemrat tona si të rritur, nuk është më një ide e re: trauma dhe çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD) kaluan shumë kohë më parë nga literatura psikiatrike në përdorim të zakonshëm dhe në filma me superheronj. Megjithatë, trauma dhe çrregullime të tilla vazhdojnë të konsiderohen disi të pazakonta kur bëhet fjalë për jetën e shenjtores, ku tendeca është për të shikuar Zotin, dhe jo teorinë frejdiane apo forca konfliktuese historike jo personale, si shkak kryesor për çdo rezultat.

Alpiion, që e konsideron veten si ‘rationalist shpirtëror’ (spiritual rationalist), e shikon të nevojshme të theksojë: “Nuk kam asgjë kundër atyre që mendojnë se çfarë ndodhi me Terezën ishte ‘ndërrhyrje hyjnore’. Por si studiues i shkencave sociale, është e natyrshme që të jap mendimet e mia në mënyrë që aspekte të tjera të mos injorohen.”

Atyre që u pëlqejnë që shenjtorët e tyre të jenë ‘jo të ndërlikuar’ mund të zgjedhin të mos i kushtojnë vëmendje Alpiion. Por Nënë Tereza ka kohë që nuk ka qenë një qenie e ‘pa ndërlikuar’. Dhe At James Martin, një jezuit që shkruan shpesh për Terezën, vëren se katolicizmi pranon idenë se mirësia rrjedh nga një bazë. “Le të marrim një shembull nga familja”, thotë ai. “Nëse dikush është keqtrajtuar si fëmijë, ai person kur të rritet mund të jetë më i predispozuar t’i kuptoj fëmijët e keqtrajtuar. Zoti i përdorë këto përvoja dhe mund t’i transformojë ato, duke i bërë objekte mirësie për njerëzit e tjerë.”

Kjo do të ishte me vlerë të kihat parasysht ndërsa më shumë boshllëqe vazhdojnë të plotësohen në jetën e hershme të Terezës. Alpiion do t’i vazhdojë hulumtimet. Dhe Ati Brian Kolodiejchuk, postulatori i Kishës, që grumbulloi një dosje të madhe në mbështetje të shenjterimit të saj, pritet të botojë një biografi.

Zbulimet e reja që do të pasojnë, edhe pse mund të interpretohen nga dikush si ‘zbehe’ e shenjtërisë së saj, në fund të fundit, me siguri do të nxjerrin më mirë në pah një Tereza edhe më të ndërlikuar, nën efektin e faktorëve historikë – etnikë, politikë dhe epidemiologjikë – dhe që për pasojë e influencuan atë në mënyrë të dukshme apo të padukshme. Kjo ka vlerën e saj.

Ndërsa po lexojmë këtë shkrim – bota e madhe vazhdon të rrotullohet duke mbeur në thelb e njëjtë – mijëra refugjatëve të rinj u ka therur në palcë humbja e të dashurve nga pandemia apo janë detyruar të largohen nga vendet e tyre, për të shpëtuar nga tiranët e kohës tonë. Të kapur në kurthin e historisë, secili përpjetet të gjejë kuptim dhe shpresë.

Aktualisht, shumica në këtë grup të veçantë jenë të krishterët ortodoksë e jo katolikët romakë. Megjithatë, shumë nga admiruesit e Terezës, kur ajo ishte gjallë, nuk ishin katolikë. Për ta, ajo ishte një shenjtores me ‘S’ të vogël. Në këtë kontekst, siç shprehet At Martin, Tereza “mund të jetë shenjtorja e momentit”. Ashtu si më parë! Përktheu Arben Çokaj



The Chambers of
Mr Tejpal Singh Chodha
BARRISTER & COMMISSIONER
OF OATHS
13 Manor Rd,
Gravesend DA12 1AA
Tel: 01474 326666

Immigration

**ALL IMMIGRATION
AND HUMAN RIGHTS
APPLICATIONS AND
APPEALS;**

- Consultants for divorce
- Family and child applications
- Lasting Powers for health and Finance
- Powers of Attorney for Sale
- Sponsorship Declarations for Family Visits

**Contact us for
Sponsorship Licences
to enable firms to
sponsor staff from
overseas and wills
and probate
applications**

**WE UNDERTAKE POWER
OF ATTORNEYS FOR ALL
KINDS OF PROPERTIES
OVERSEAS**

Mob:07453 466 769



DAUT DAUTI

Sa më shumë që zgjat kjo luftë, izraelitët dhe bota do ta kuptojnë se përdorimi i dhunës nuk është përgjigje. Fakti që ushtria izraelite tashti është prezente në pjesën e Gazës veriore, të cilën tani më e ka rrafshuar përtokë, dhe që ende nuk është në gjendje ta realizojë atë që e ka proklamuar, është problematike. Qeveria izraelite tani më e ka pranuar propozimin për ndërrim të të burgosurve, përkundër faktit se kishte deklaruar se këtë nuk do ta bëjë pa e mposhtur Hamasin.

Lufta izraelito-palestineze ka nisur para 75 viteve. Gjatë kësaj periudhe ka pasur luftëra ku janë përfshirë edhe shtetet fqinje të Izraelit (Siria, Jordania dhe Egjipti) dhe luftëra me intensitet më të ulët me palestinezët, që mund të cilësohen si të brendshme ose dypalëshe, e që kanë qenë pothuaj të përhershme.

Por, kjo që filloi me 7 tetor me sulmin e Hamasit, e ka tronditur botën e, aq më tepër, Izraelin, më shumë se ato të mëparshmet. Luftërat izraelito-palestineze gjithmonë kanë krijuar efekt global. Shtetja e pasojave është aq e gjerë, saqë, për krahasim, lufta mes Rusisë dhe Ukrainës, që deri me 7 tetor merrej si kërcënim për një luftë të re botërore, tashti gati është haruar.

Pa marrë parasysh që ky konflikt është i gjatë tre çerekë shekuj, Izraeli dhe bota perëndimore, në krye me

SHBA-në, u munduan ta imponojnë një diskurs që tentonte ta shpjgojë këtë problem sikur që filloi me 7 tetor. Këtë rrugë e ndoqën edhe shumica e mediave të këtyre vendeve. “Do you condemn Hamas?” (A e dënoni Hamasin?) ishte pyetja e parë dhe standarde që u parashtruhej të gjithë atyre që dilnin në mediat perëndimore në përkrahje të çështjes së Palestinës. Nga përgjigjja varej nëse vazhdonte ose ndërpritej intervista apo diskutimi. Natyrisht, që sulmet e Hamasit (vrasja e civilëve, kryesisht grave dhe fëmijëve), ishin të karakterit terrorist, por Hamasi nuk bëri diçka që më parë nuk e kishte bërë Izraeli. Qëllimi ishte që të injorohet e kaluara 75-vjeçare e konfliktit dhe gjithçka të fillonte me këtë datë dhe me këtë pamje terroriste, që kërkonte pasimin e domosdoshëm të dënimit kolektiv të palestinezëve, e cila është duke vazhduar.

Izraeli dhe përkrahësit e tij perëndimorë nuk kanë qenë të gatshëm të ofrojnë zgjidhje përfundimtare. Gjendja e krijuar ka ofruar pamje të rrejshme të qetësisë mes Izraelit dhe Palestinës.

Në mënyrën më të vrazhdë Hamasi tregoi se gjërat janë shumë keq. Habia e krijuar nuk ka të bëjë vetëm me vrasjen e civilëve. Në realitet, Hamasi i ka ngritur dy pyetje fundamentale në lidhje me Izraelin.

Pyetja e parë që u ngrit në Izrael ishte: si është e mundur që ushtria izraelite e përqendruar në disa vendvështime rreth Gazës dhe me tërë atë teknologji, të shkatërrohej aq shpejt nga Hamasi? E dyta: Ku ishte Mosadi që nuk e kishte hetuar këtë përgatitje dhe sulmin?

Pra, Hamasi, duke i vrarë më shumë se 300 ushtarë izraelitë brenda pak orëve dhe duke e shkatërruar sistemin elektronik të kontrollit të Gazës dhe lidhjeve, e ka dëmtuar rëndë mitin e ushtrisë izraelite dhe të sigurimit sekret (Mosadit). Kjo ishte një brengë

edhe për SHBA-në dhe Britaninë e Madhe, të cilat menjëherë i dërguan flotat e tyre detare në pjesën e Mesdheut dhe afër Izraelit. Kjo gjë u bë me qëllim që kjo lëvizje të shihej si shenjë e gatishmërisë së këtyre vendeve nëse konflikti zgjerohet. Në realitet, ushtria izraelite është e fuqishme për shumicën e vendeve të rajonit, por çka do të ndodhte nëse kjo ushtri njëkohësisht do të ballafaqohej edhe me atë të Egjiptit dhe Arabisë Sauditë, që janë pajisur me të madhe gjatë tri dekadave të fundit? Izraeli me siguri do t'i frikësohej shumë përgjigjes së kësaj pyetjeje.

Në realitet, Egjipti dhe Arabia Saudite, sikur edhe disa vende tjera arabe përreth Izraelit, nuk mund të bëjnë asgjë. Qeveritë e këtyre vendeve janë të lidhura aq shumë me SHBA-në, saqë qëndrimi i tyre në pushtet varet nga disponimi në Uashington. Si do ta nisnin këto vende luftën me Izraelin edhe kur dihet se armatimi i tyre është pothuaj tërësisht i prodhimit amerikan, britanik e francez? Shtu këtu që këto tri shtete perëndimore kanë deklaruar se Izraeli do ta ketë ndihmën e rezervë politike, sidomos ushtarake, nga këto tri vende. Pra, nuk ka gjasa për zgjerim të konfliktit, andaj palestinezët mbeten në gjendjen që kanë qenë. Nga kjo është krijuar një status quo që e ka trimëruar Izraelin dhe rehatuar Amerikën. Por, gjendjet, çfarëdo qofshin ato, nuk janë të përhershme.

Edhe në këtë luftë, që është duke vazhduar, e para që vritet është e vërteta. Vendet në konflikt dhe aleatët e tyre dëshirojnë ta krijojnë narracionin që u siguron moral përbrenda dhe përkrahje në botë. Sado që është bërë mund i madh në këtë drejtim, në kushtet e sotshme është bërë e zorshme të disajnohet dhe të kontrollohet informata. Por, Perëndimi, që trumpeton se e mban flamurin e shprehjes së lirë, nuk është treguar i tillë në rastin e kësaj lufte. Ç'është e vërteta, më të lira dhe më reale janë duke u

treguar disa media brenda vetë Izraelit. Përkundër vështirësive që kanë ata në plasimin e pikëpamjes palestineze, kjo gjë nuk ka mundur të bllokohet. Edhe në këtë aspekt kanë ndryshuar gjërat, sidomos në Britani të Madhe. Tashti, gjithnjë e më shumë ka njerëz që me elokuencë e elaborojnë pozitën palestineze para publikut britanik. Nuk është fjala vetëm për ata që janë palestinezë, arabë ose myslimanë, por edhe nga radhët e anglezëve dhe hebrejve që nuk mund ta durojnë këtë gjendje të rëndë në të cilën janë futur të dyja palët. Sipas mediave, kryesisht britanike, shohim se është shtuar numri i intelektualëve dhe personalitetëve me ndikim brenda hebrejve, gjë që kërkon zgjidhje përfundimtare. Sipas disa sondazheve, rreth 30% e hebrejve amerikanë nuk e përkrahin politikën e tashme izraelite, kurse përqindja te moshat e reja është edhe më e lartë. Demonstratat masive për ndaljen e luftës dhe për të gjetur zgjidhje të këtij konflikti do të shtohen.

Megjithatë, ky aktivitet nuk e ndryshon shpejt gjendjen e rëndë aktuale. Ky është parashikimi se çka mund të ndodhë në të ardhmen. Problemi kryesor i ndryshimit të marrëdhënieve armiqësore izraelito-palestineze ende varet nga opinioni publik në SHBA. Është e vërtetë që në këtë vend hebrejët dhe lobi i tyre ka ndikim të madh, por fakti që shpesh nuk merret parasysh është se pas politikës proizraelite në SHBA qëndrojnë grupet e evagjelistëve të krishterë, që janë kryesorët dhe ndikimi i tyre politik dhe fuqia financiare janë tejet të mëdha.

Evagjelistët bazohen në profecitë biblike se amerikanët duhet t'i ndihmojnë Izraelit që atje të kthehen të gjithë hebrejët, në mënyrë që të vriten në ditën e ardhjes së Mesihut të Premtuar, i cili do ta sigurojë fitoren e Krishterimit. Kjo është “ndihmë” që pas ka një

arsye jonjerëzore, pasi që përmban planin për shfarosjen e hebrejve. Megjithatë, jo moti, mu këto organizata evagjeliste i ka falënderuar Netenjahu për ndihmën e madhe që janë duke e dhënë për shtetin e Izraelit. Pra, në SHBA presioni bëhet për ta vazhduar luftën e jo për ta ndaluar.

Përkundër kësaj përkrahjeje, Izraeli do ta ndiejë presionin për paqe. Sa më shumë që zgjat kjo luftë, izraelitët dhe bota do ta kuptojnë se përdorimi i dhunës nuk është përgjigje. Fakti që ushtria izraelite tashti është prezente në pjesën e Gazës veriore, të cilën tani më e ka rrafshuar përtokë dhe që ende nuk është në gjendje ta realizojë atë që e ka proklamuar, është problematike. Qeveria izraelite tani më e ka pranuar propozimin për ndërrim të të burgosurve, përkundër faktit se kishte deklaruar se këtë nuk do ta bëjë pa e mposhtur Hamasin.

Ndoshta pyetja më serioze për ushtrinë dhe shërbimin sekret izraelit është: pse nuk po i gjeni të kidnapuarit në Gazë kur tani jeni aty dhe gati në kontroll të plotë të territorit? Kjo duket një punë e vështirë, edhe pse dihet se Gaza nuk është vend më i madh se territori nga Shkupi në Tetovë me fshatrat përreth.

Ka një varg pyetjesh të tjera që do të dalin me kohë. Por, si do që përfundojë kjo luftë, kërkohet zgjidhje e përhershme e këtij konflikti. Ndoshta, tashti përfundimisht ka ardhur rasti i shprehjes që thotë se nuk bëhet mirë pa u bërë shumë keq.

Zgjidhja e këtij problemi gjithmonë varet nga roli amerikan dhe, pjesërisht, nga ai britanik. Në Amerikë momentalisht nuk duket ndonjë disponim pozitiv, por duhet shpresuar se presidenti amerikan dhe qeveria britanike do të ndërmarrin masa në mënyrë që të tregohen të suksesshëm për shkak të zgjedhjeve që mbahen në vitin e ardhshëm.

LUTFI DERVISHI

Lajm i madh sonte është vendimi i Këshillit Europian që në kushtet e agresionit rus ndaj Kievit, në kushtet krizës në Lindjen e Mesme mori vendimin për të hapur negociatat me Ukrainën dhe Moldavinë! Gjeorgjia merr statusin e vendit kandidat. Bosnja-hap negociatat sapo të plotësojë disa kushte.

Momenti i artë gjeopolitik solli vendime të rëndësishme për të ardhmen e BE-së. Por në këtë radhë morëm “fjalë të mira dhe gurë në trastë”.

Shqipëria, “Europa e Ballkanit” për shkak të vetos greke është bllokuar për të marrë datën për Mbledhjen Ndërqeveritare.

Nëse nuk do të ishte veto greke, sot do të ishte një lajm i mirë edhe për Shqipërinë.

Greqia po dëmtton Shqipërinë duke e bërë mizën buall. Nuk është gjest miqësor ndaj fqinjit bllokimit.

Por, duam apo nuk duam, Greqia e ka treguar se ka bllokuar Maqedoninë për 10 vite për emrin, duam apo nuk duam Greqia një çështje dypalëshe e ka shtruar në tavolinën e 27 vendeve anëtare. Para interesave të mëdha, vendet aspirante në BE dhe NATO kanë marrë vendime të vështira, - Maqedonia, përballë Athinës dhe Sofies, Suedia para kërkesave të

Turqisë për anëtarësim në NATO.

Çfarë kërkohej nga Shqipëria në këtë moment?

Shqipëria ka qenë e paralajmëruar prej kohësh për çështjen Beleri. Minimumi që mund të bëhej është një Beleri të mos kthehej në bela. Kanë qenë, dhe janë të gjitha mundësitë, që vetë Drejtësia jonë tepër perfekte, pas 7 muajsh të kishte mbaruar hetimin dhe gjykimin për një çështje në flagrancë. Vetë kryeministri mund të kishte bërë mesazhe politike për një hetim të shpejtë, profesional dhe të pavarur.

Pastaj nuk shkon që ne angazhohemi të zgjidhim mosmarrëveshjet mes Serbisë dhe Kosovës, të angazhohemi të zgjidhim probemin e madh të Italisë me refugjatët, dhe për më tepër të sugjerojmë edhe formula për zgjidhjen e konfliktit 75 vjeçar mes Izraelit dhe Palestinës.

Humbja e kësaj date kalendarike në rrugën drejt BE-së nuk është fatale sepse jemi mësuar që vonesat kryesisht i shkaktojmë vetë (kujto rastin e këshillit të qarkut të Fierit që u bë problem i madh për opozitën e kohës për të votuar 3 ligjet më 2012 që na kushtuan më shumë se 10 vjet)

Por këtë radhë me zgjedhjet e reja për

Parlamentin Europian dhe kohën që do të marrë procesi i konstituimit të Parlamentit dhe formimit të Komisionit të ri, mund të humbasim plot dy vjet. Dhe ky nuk është lajm i mirë për “ushtrinë” prej 1000 personash që punoi me dedikim dhe entuziazëm gjatë procesit të skanimit. Nuk është lajm i mirë as për vendin.

Çështja Beleri do të zgjidhet, por është një çështje që për një plesht po “djegim” jorganin.

Dhe për këtë nuk na ndihmon dot Inteligenca Artificiale. Duhet përdor Inteligenca Natyrale.

BELERI, BELA ME DUART TONA

IRENA BEQIRAJ

Një telefon i Kryeministrit me Mira Muratin mjaftoi që "Inteligjenca Artificiale" të ishte shprehja më e përdorur gjatë fjalimeve të ministrave edhe vetë Kryeministrit në Kongresin e Jashtëzakonshëm të Partisë Socialiste, ku u shpaleshën prioritetet qeverisëse deri në 2030. U premtua përdorimi i gjerë i Inteligjencës Artificiale duke filluar nga prokurimet, buqësia, edukimi, shendetësia, drejtësia e deri tek procesi negociues me Bashkimin Europian.

Pse jo, tanimë është një tezë e gjithëpranuar që teknologjia përmirëson jetën e njerëzve, duke ofruar zgjidhjet më të mira dhe më të lira. Sot përshembull me anë të telefonave celularë komunikojmë në distanca të largëta pa pasur nevojë për investime të kushtueshme në linja fikse dhe infrastrukturë tjetër mbështetëse. Po kështu, me anë të mobile banking është mundësuar akses në shërbimet financiare pa pasur nevojë për një mbulim të gjerë me degë bankare në zonat e largëta. Por që teknologjia të japë një kontribut real dhe të qëndrueshëm në zhvillim, ajo nuk duhet vetëm të ofrojë produkte më të mira dhe më të lira por ajo duhet të cojë në më shumë vende pune me pagë më të lartë.

Me fjalë të tjera, në një ekonomi përdorimi i teknologjisë duhet të rezultojë në përfshirjen e kapitalit human në përmirësimin apo edhe prodhimin e teknologjive të reja. Sot në Shqipëri ne përdorim telefona celularë por nuk i prodhojmë ato. Padyshim ne do të përdorim edhe Inteligjencë artificiale, por sërish shtrohet pyetja a mundim ne të ndryshojmë atë që është thelbësore për ekonominë edhe e vështrirë për tu arritur produktivitetin? Ose për ta sjellë më mënyrë më të kuptueshme për lexuesin këtë

A MUNDËT NJË MAJMU, VETËM SE KA HIPUR NË PEMË, TË PRETENDOJË QË DO TË SHKOJË NË HËNË?



pyetje "a mundet një majmun vetëm se ka hipur në pemë të pretendojë se do të shkojë në Hënë?"

Për të ilustruar argumentin tim, kësaj here nuk do t'u referohem eksperiencave që vijnë nga bota, por eksperiencës sonë. Në janar të vitit 2019 sërish Kryeministri shpali në disa dalje publike vizionin për ta transformuar Shqipërinë në një hub të teknologjisë së Blockchain ose në një vend pionier të ofrimit shërbime të sofistikuar në fushën e FinTech-ut. Drejtësisht qeveria vlerësoi se kishte një kërkesë globale dinamike në rritje të këtij sektori ndërkohë që sektori gëzonte edhe avantazhin e barrierave të ulta të hyrjes. Ndaj me miratimin e ligjit 66 të vitit 2020 Shqipëria u bë një nga vendet pioniere në Europë që ofroi një ekosistem të rregulluar me

anë të të cilit pretendohej se ekonomia do të materializonte perfitime të mëdha nga ofrimi dhe tregtia e asetëve virtuale (ndryshe të njohura edhe si krypto monedhat).

Sot kanë kaluar 3 vite nga miratimi i kësaj regullatore edhe asgjë nuk ka ndodhur. Madje nuk ka pasur asnjë aplikim për licensim dhe rrjedhimisht asnjë aktivitet i licensuar nuk kryhet në Shqipëri.

Kjo histori tregon që vetëm "vullneti i mirë" edhe legjislacioni nuk mjaftuan. Të zhvillosh edhe të përdorësh gjerësisht teknologjitë inovative siç është Blockchain apo modelet inteligjencës artificiale në ekonomi duhet të sigurohen disa ingredientë të nevojshëm.

E para Shqipërisë i mungonte edhe i mungon edhe sot një autoritet përgjegjës për teknologjitë inovative të informacionit (ku futet edhe Inteligjenca artificiale), cili të shërbejë jo vetëm si: 1) ofruer të infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e teknologjive inovative edhe inteligjencës artificiale, 2) si motor i krijimit dhe shpërndarjes së njohurive të reja, por dhe si 3) autoritet rregullues dhe mbikëqyrës. Nëse në politikë-bërje apo ne publik dikush mendon se këtë funksion kryen AKSHI gabohet rëndë, sic gaboi ne rastin e Blockchain -it.

Së dyti implementimi i një teknologjie të re inovative sic ishte edhe ofrimi i produkteve financiare dhe shërbimeve financiare në blockchain, paraqiste sfida të mëdha

pasi kërkonte që sektori privat të pajisej me kapital njëzëror të përgatitur me njohuri edhe aftësi në shkencat kompjuterike, kriptografi, shërbimet financiare, por dhe me njohuri specifike legjislative. Ky kapital njëzëror mungonte dhe duhej përgatitur. Edhe nëse ka një fushë ku kemi pesuar regres në vend të progresit është kapitali njëzëror.

Së treti, për të intensifikuar aktivitetet e kërkim zhvillimit në teknologjitë inovative, qeveria duhet t'ju ofronte firmave pinonere stimuj e nevojshëm dhe bashkëfinancim, pra ka nevojë. Gjatë gjithë historisë, ndryshimi teknologjik ka krijuar fitues dhe humbës edhe neglizhimi në përmirësimin e elementëve thelbësorë të mësimin, na ka rreshtuar tek humbesit ose përdoruesit pasivë të zhvillimit teknologjik.

Po ashtu eksperimentet e profesorit të Yale-it Keith Chen kanë treguar që shimpanzetë mund të pretendojnë të shkojnë edhe në Hënë nëse edukohen, por faktikisht qe prej 1961 e deri tani ato përdoren vetëm si kavje për të testuar efektet e fluturimit në hapësirë.

Në ekonomi kam mësuar një parim: që njerëzve është mirë t'ju japësh ose një parashikim ose një datë, por kurrë mos ua jep të dyja.

Parashikimi edhe pse shumë i guximshëm se modelet e inteligjencës artificiale do të revolucionarizojnë ekonominë tonë nuk është i pamundur.

Thjesht nuk dimë se kur kjo mund të ndodhë.



MONIKA STAFA

Në fundin e viteve 1990, shqiptarët kishin shpresë se Shqipëria do të hynte në një epokë të re. Atë të një zhvillimi normal politik. Me rregullimin që sjell vetvetiu antinomia "pushtet – qeveri".

Kështu ndodh në historinë e pushteteve në Perëndim – në demokracitë perëndimore apo ato me demokraci liberale, siç quhet në

NGA DHJETORI NË DHJETOR

gjuhën e sotme të historiografisë botërore. Dhe, ja, në Shqipëri u themelua opozita e parë politike, me program të djathtë dhe me populizëm të majtë. Ndodhi në dhjetor të vitit 1990. U krijua Partia Demokratike e Shqipërisë. Ndërsa, Partia Komuniste e atëkohshme vendosi të kthehej në parti parlamentare.

Ajo pranoi të përballonte konkurrencë duke hequr dorë nga privilegji kushtetues i hegjemonisë mbi pushtetin. Por, a po krijohej vërtet një sistem politik parlamentar me të gjitha virtytet e veta? Çfarë po ndodhte me shqiptarët? Përse ata u gënjyeshin sërish? Ishte koha kur salla e shfaqjeve të Akademisë së Arteve mbusheshin me intelektualë që e kishin kuptuar se kishte ndërruar forma e luftës politike. Por, jo lufta në tërësi. Ishin krijuar rreshtimet e reja. Por, ende opozita nuk e kishte marrë fytyrën që duhej. Dhe, as pushteti i vjetër nuk

ishte i gatshëm të dorëzohej apo të tërhiqej. Dhe, as nuk do të ndodhte edhe për shumë kohë.

Megjithatë, revolucionet kishin mbaruar. Koha e mendjes dhe e punës kish ardhur. Ky ishte një mesazh që intelektualëve të asaj kohe u vinte publikisht prej zërave perëndimorë. Kështu ata i ikën rrugës dhe manifestimit publik. Një grupim i vogël njerëzish të mendjes bënë hapin e parë për institucionalizimin e një opozite mirëfilli si të tillë.

Themeluan institucionin e refleksioneve. Institucionin që pretendonte të kthente luftën politike në opozitarizëm. Po përse 'refleksionet' nuk arriti dot të kryhej? E aq më pak të përkryhej ky institucion? Kush e pengoi? Dhe, kush e ngatërroi fillin e kësaj historie? Sot pas 33 vitesh është e vështirë të pohosh. Të pranosh. Apo

dhe ta shpjegosh pse në Shqipëri opozitarizmi nuk ka shkëlqyer ndonjëherë.

E vërteta është se pushteti qarkullon, çfarë do të thotë se në Parlament ka të majtë e të djathtë. Po ku mbeti ajo Shqipëri që do duhej të bëhej herët? Ai brez i fundviteve 1980 që shënjoji historinë politike të mendimit ndryshe? Larg asaj që nisi gjithsecili tanimë kish zënë një vend: dikush politikisht i angazhuar, dikush midis politikës e mendimit, dikush individ i vetëveçar. Edhe njëherë u provua se opozitarizmi në Shqipëri erdhi si shkëlqimi i shkurtër i shkrepjes së një vetëtime.

Në formën e një dehjeje emocionale që nuk njohu dot themele të forta për t'u rritur. Në mendim dhe platformë. Duke sjellë si rrjedhojë errësirën e mendimit dhe një luftë të gjatë dhe tani krejt të vjetër politike. Në këto

dekada fushatat e zgjedhjeve kanë njohur një garë palësh vazhdimisht në luftë politike. Pa mendim. Pa platformë. Pa ide. Sepse edhe sezonet e lëvizjeve të mendimit dhe të shpirtit idealist në Shqipëri kanë qenë thjesht stacione të shkurtra kalimtare në rrugën e jetës së shtetit politik shqiptar.

Pak opozitarizëm e shumë luftë politike. Sepse ka pasur akoma dhe më pak idealizëm ndër mendimtarët apo refleksionistët e tij. Mendja politike "pushoi" së reflektuari dhe vendin e saj e zuri veprimi politik. Ata të cilët e kanë pasur vokacion të brendshëm zhvillimin e opozitarizmit lanë garën në mes dhe qëllimin nuk mundën ta çojnë deri në fund. Si të ringjallet opozitarizmi, si të funksionojë parlamentarizmi, si të kthehet lufta politike në garë alternativash, si të shpëtohet nderi i vendit nga mungesa e mekanizmave bazë të rregullimit shtetëror; a nuk është e lehtë ajo që duhej të ndodhte? Pra, si të qeveriset Shqipëria ndryshe! E jo si ta marrim pushtetin!

PANSERBIZMIN “DO TA NDALTE ZGJERIMI I NATO-S” NË BALLKAN

REL

Fitorja e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç, është negative dhe e rrezikshme, në radhë të parë për stabilitetin e Bosnje dhe Hercegovinës, por edhe të Malit të Zi dhe Kosovës, sepse ai, përmes aleatëve të tij në këto vende, do ta prezantojë veten dhe Serbinë si lojtarë të vetos në rajon, thotë analisti nga Podgorica, Zlatko Vujović, për Radion Evropa e Lirë. Dhe këta aleatë ishin pranë tij në natën kur ai shpalli fitoren në zgjedhje.

Millorad Dodik nga Bosnje dhe Hercegovina dhe Andrija Mandić nga Mali i Zi ishin në skenë më 17 Dhjetor, kur Vuçiç tha se Partia e tij Përparimtare Serbe i ka fituar zgjedhjet parlamentare në Serbi.

Të dy ata, përndryshe, janë zyrtarë të lartë të vendeve të tjera, Dodik është president i Republikës Srpska në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa Mandić është kryetar i Kuvendit të Malit të Zi.

Pikërisht përmes tyre, Serbia do të përpiqet të ndikojë në politikën e fqinjëve të saj, thotë Vujović.

“Këtu e kam fjalën për partinë e Mandićit, veprimet e Dodikut, por edhe për Listën Serbe në Kosovë. Prandaj, Serbia do të paraqitet si një lojtarë e vetos, e cila nëse nuk mund ta kontrollojë dhe menaxhojë procesin e integritimit evropian, mund ta bllokojë atë. Është shumë e rrezikshme për Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinën dhe Kosovën”, thotë Vujović.

Dodik është udhëheqës pro-rus i serbëve në Bosnje dhe Hercegovinë dhe është nën sanksionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mandić është udhëheqës i Frontit Demokratik pro-rus, i shpërbërë së voni, dhe me vite ka bërë thirrje për tërheqjen e njohjes së Kosovës nga Mali i Zi. Ai, po ashtu, e kundërshton anëtarësinë e Malit të Zi në NATO.

Burim Ramadani, ekspert i sigurisë dhe ish-drejtor i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, thotë se anëtarësimi i Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës në NATO, do t'i kufizonte tendencat negative të Serbisë në rajon, e cila, siç shprehet, vazhdon ta promovojë panserbizmin [v.j. ideologjinë e ‘Serbisë së Madhe’] dhe ta kërcënojë qëndrueshmërinë e Ballkanit Perëndimor.

“Shfrytëzimi i votuesve” nga rajoni për ta forcuar botën serbe

Në kuadër të mbështetjes për serbët jashtë Serbisë, Beogradi zyrtar përkrah politikisht dhe financiarisht forcat e Dodikut dhe ato të Mandić.



Por, Vujović thotë se bashkëpunimi i Vuçiç me Mandić dhe Dodikun mund të përfshijë edhe mënyra të tjera ndihme, përveç këtyre. Ai thotë se rreziku më i madh është shfrytëzimi i votuesve nga vendet tjera për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve në vendin ku mbahen – gjë që ndodhi në zgjedhjet e fundit në Serbi.

Ky fenomen, sipas Vujovićit, nuk është i ri. Në disa palë zgjedhje të fundit në Mal të Zi kanë votuar votues të saporegjistruar nga Bosnje dhe Hercegovina, përkatësisht nga Republika Sërpska, duke ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.

“E njëjta gjë është edhe në Serbi. Tashmë në disa zgjedhje, një numër i madh i votuesve nga Republika Srpska, veriu i Kosovës dhe Mali i Zi shkojnë në Serbi, e regjistrojnë vendbanimin e tyre ilegalisht dhe pastaj marrin pjesë edhe në zgjedhjet lokale në Beograd, të cilat janë shumë të rëndësishme”, thotë Vujović.

Sipas tij, bëhet fjalë për “marrje me qira të dyanshme” të votuesve.

“Nga Serbia dhe Bosnja vijnë në Mal të Zi për të votuar, nga Mali i Zi, Kosova dhe Republika Sërpska shkojnë për të votuar në Beograd. Kjo është shumë destabilizuese për rajonin”, thotë Vujović.

Ai beson në pretendimet se Mandić dhe Dodik janë angazhuar për dërgimin e votuesve nga Mali i Zi dhe Bosnje dhe Hercegovina në Serbi.

“Duke i nxjerrë ata pranë vetës kur ka shpallur fitoren, ai ka treguar respekt për ta dhe mirënjohje për kontributin e tyre në rezultatin zgjedhor. Ata kanë sjellë votues në Serbi ose i kanë mobilizuar ata në vendet e tyre për të votuar në misionet diplomatike serbe”, thotë Vujović.

Ai, po ashtu, beson se Vuçiç, përveç

partitë nga Fronti Demokratik, kontrollon edhe pothuajse të gjithë shumicën parlamentare në Mal të Zi.

Kjo shumicë e ka zgjedhur Qeverinë e Millojko Spajçit në fund të tetorit të këtij viti. Gjatë negociatave, Vuçiç ka thënë se “Serbia është e interesuar vetëm për të drejtat e 30 për qind të serbëve që jetojnë në Mal të Zi”.

Edhe pse mohon se Beogradi është duke ndërhyrë në regjistrimin e popullsisë në Mal të Zi, Vuçiç vazhdimisht ka folur për rëndësinë e këtij procesi për të përcaktuar numrin e saktë të serbëve në Mal të Zi.

Anëtarësimi në NATO, zgjidhje për Kosovën dhe Bosnjën

Ish-drejtori i AKI-së, Burim Ramadani, thotë për Radion Evropa e Lirë se zgjedhjet në Serbi kanë treguar se “rrjeti nacionalist” në këtë vend “vazhdon të gëzojë mbështetje të madhe” dhe si i tillë “ka marrë edhe mbështetjen e udhëheqësve serbë në vendet e tjera, përfshirë Bosnje dhe Hercegovinën dhe Malin e Zi”.

“Nëse shikojmë se si [partitë në Serbi] e kanë bërë fushatën zgjedhore, atëherë vëmë re se bëhet fjalë për panserbizëm. Udhëheqja aktuale, e cila tashmë edhe është konfirmuar, promovon panserbizmin dhe kështu kërcënon sigurinë dhe qëndrueshmërinë e Ballkanit Perëndimor”, thotë Ramadani.

Ai shton se panserbizmi, i cili në të kaluarën kishte edhe emra të tjerë, si ‘Serbia e Madhe’ dhe ‘Bota serbe’, tani mund të kalojë në ‘konfederatë të territoreve serbe’, e cila është gjithashtu një lloj kërcënimi për Ballkanin Perëndimor.

Ramadani thotë se një ideologji e tillë mund të ndalet vetëm me zgjerimin dhe praninë e mëtejshme të NATO-s në rajon, si dhe me ndëshkimin e drejtpërdrejtë të udhëheqjes së Ser-

bisë, e cila promovon ideologji të ekstremizmit dhe nacionalizmit.

“Kosova dhe Bosnje dhe Hercegovina duhet t’i bashkohet NATO-s me hapa të përshpejtuar dhe, në të njëjtën kohë, Serbia duhet ta marrë dënimin e merituar nëse vazhdon të promovojë ideologji nacionaliste të panserbizmit, qoftë duke futur në listën e zezë individë të saj, qoftë duke e hequr atë nga [programi i NATO-s] Partneriteti për Paqe, për fillim”, thotë Ramadani.

Ai shton se bashkësia ndërkombëtare, përkatësisht NATO-ja, është e vetëdijshme për ngjarjet në rajon dhe është i bindur se Serbia nuk do ta ndryshojë ideologjinë e saj aktuale.

“Kështu që NATO-ja do të detyrohet të zgjerohet në Ballkanin Perëndimor dhe gjithashtu ta ndëshkojë udhëheqjen serbe”, thotë eksperti i sigurisë.

NATO-ja ka nisur ta forcojë praninë e saj në Ballkan, duke dërguar forca shtesë në Kosovë, pas sulmit të armatosur në Banjskë. Në këtë fshat në veri të Kosovës, grupe të armatosura serbësh kanë sulmuar policinë e Kosovës më 24 Shtator, duke vrarë një polic.

Përgjegjësinë për organizimin dhe pjesëmarrjen në sulm e ka marrë Millan Radoičić, ish-nënkryetar i Listës Serbe – partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit.

Sitarski: Ndikimi i Vuçiç në Banja Llukë është dobësuar

Fakti që Dodik dhe Mandić ishin në podium pranë Vuçiç, Millan Sitarski, nga Instituti për Kërkime Sociale-Politike në Mostar, thotë se është përpjekje e tyre për të tërhequr një pjesë të kapitalit politik të presidentit të Serbisë.

“Marrë parasysh se ai është president i Serbisë, ka mbështetjen që e ka dhe

ka 11 vjet që është në pushtet, ata shohin në këtë arsye për ta transferuar një pjesë të kapitalit të tij simbolik te vetja e tyre”, thotë Sitarski.

Sipas tij, prania e Dodikut pranë Vuçiç tregon gjithashtu se ata i kanë përmirësuar marrëdhëniet, të cilat janë ftohur para zgjedhjeve të përgjithshme në Bosnje dhe Hercegovinë në tetor të vitit 2022, kur Vuçiç ka refuzuar ta mbështesë Dodikun dhe ka mbështetur kundërshtarët e tij.

Pavarësisht kësaj, Dodik është zgjedhur president i Republikës Sërpska.

Nisur nga kjo, Sitarski beson se ndikimi i Vuçiç në Republikën Sërpska është më shumë simbolik sesa efektiv – pra, ai “nuk ka arritur që pushtetin dhe ndikimin konkret që ka në Serbi, ta transferojë përtej Drinës”.

“Vuçiç sigurisht, mund të ndikojë te një pjesë e qytetarëve të Republikës Sërpska. Ai ka bërë përpjekje që edhe në Republikën Sërpska të veprojë si lojtar i pavarur politik, duke themeluar Partinë Përparimtare Serbe (SNS), si ekskluzivitet të SNS-së serbe...”, thotë Sitarski për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se Dodik ka qenë i pari që është zbutur pas ftohjes politike të marrëdhënieve mes Beogradit dhe Banja Llukës, duke kujtuar se, në maj të këtij viti,

Dodik ka mbështetur publikisht Vuçiç-in në një tubim në Beograd.

Në atë kohë, dhjetëra mijëra qytetarë kanë protestuar në rrugët e Beogradit, të pakënaqur me reagimin e autoriteteve pas dy vrasjeve masive në Serbi, në muajin maj.

Sitarski beson se ka një rivalitet mes Dodikut dhe Vuçiçit. Megjithatë, mes tyre ka edhe ngjashmëri, si qëndrimi ndaj Kosovës, mospranimi i sanksioneve kundër Ruisë dhe afërsia me Kishën Ortodokse Serbe.

Vuçiç dhe Dodik kanë, po ashtu, marrëdhënie të mira me Moskën zyrtare. Dodik është takuar intensivisht me presidentin rus, Vladimir Putin, gjatë dy vjetëve të fundit.

Prej vitesh, ai pretendon se Bosnje dhe Hercegovina nuk është shtet funksional dhe se serbët atje janë të kërcënuar. Ai ka paralajmëruar, po ashtu, shkëputjen e Republikës Sërpska nga Bosnja.

Dodik është nën sanksionet e SHBA-së dhe Britanisë së Madhe për “minimin e legjitimitetit dhe paqes së fituar me vështirësi” në Bosnje dhe Hercegovinë./REL

NGA MAL BERISHA

Lidhja e Kombeve, si një Organizatë Ndërkombëtare erdhi fill pas Konferencës së Paqes të Parisit në vitet 1919–1920. Qëllimi i kësaj Lidhjeje ishte çarmatimi dhe parandalimi i luftërave bazuar në një siguri të përbashkët. Grindjet midis vendeve të ndryshme do të zgjidheshin nëpërmjet bisedimeve, mjeteve diplomatike dhe përmirësimit të mirëqenies globale. Filozofia e Lidhjes ishte e ndryshme me atë çfarë njerëzimi kishte bërë ndër shekuj. Ajo nuk do të kishte ushtri, prandaj mbetej të mbështetej tek forca e armëve e Fuqive të Mëdha, në mënyrë që të detyronte zbatimin e rezolutave të saj, të impononte sanksione ekonomike në raste të caktuara ose të mobilizonte forca ushtarake po ta kërkonin interesat e përgjithshëm.

Në të vërtetë një përpjekje e pasuksesshme ishte bërë në vitet 1899 dhe 1907 për të themeluar një organizatë ndërkombëtare të quajtur Konfederata e Shteteve të Hagës[1] siç e kishte pagëzuar pacifisti neo-kantian Walther Schücking'. Kjo ide ishte frymëzuar nga Emanuel Kanti në një vepër të tij filozofike të njohur me emrin "Paqa e Përfundimit" – një skicë filozofike e vitit 1795. Ky projekt dështoi për t'i lënë vendin një përpjekjeje tjetër, të ndërmarrë nga Sekretari i Jashtëm Britanik, Eduard Grey në vitin 1915. Ideja e këtij të fundit u përkrah menjëherë nga Presidenti Amerikan Woodrow Wilson dhe këshilltari i tij, Koloneli Eduard M. House. Qëllimi ishte të parandalohet gjakderdhja që po ndodhte në Luftën e Madhe. Formimi i një Lidhjeje të tillë pati në themel të saj Katërmëdhjetë Pikat për Paqen të formuluar nga Presidenti Amerikan, mbi Vetëvendosjen e Kombeve, nga të cilat pika e fundit thoshte se, duhej të formohej një Organizatë e Përgjithshme Ndërkombëtare bazuar në një marrëveshje të veçantë, me qëllim që të sigurojë garanci reciproke për pavarësinë politike dhe integritetin territorial të shteteve qofshin ato të mëdha apo të vogla. Kjo organizatë u mishërua në atë që njihet si Lidhja e Kombeve, anëtare e 42-të e së cilës u bë Shqipëria, falë mbështetjes së pakursyer të britanikëve.

ROLI I BRITANISË NË ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË

Për të ardhur deri tek anëtarësia e vendit tonë në Lidhjen e Kombeve duhej të ishin patjetër në mbështetje Britania e Madhe dhe SHBA. Ndërsa Eduard Grey e kishte treguar interesin e tij për Shqipërinë në Konferencën e Ambasadorëve të vitit 1913, në Londër, do të duhej Presidenti Amerikan Wilson që të siguronte ekzistencën e shtetit tonë në Konferencën e Paqes në Paris, 1919. Në këtë akt, rol të rëndësishëm kanë luajtur Vatanët e Amerikës nëpërmjet të delegatit të tyre në Konferencë, Reverend Charles Telford Erickson-i, pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga Turhan Pasha. Kjo jo vetëm do të ruante kufijtë e 1913-ës, por do të hapte rrugën për anëtarësimin e Shqipërisë në Lid-

103 VJET NGA PRANIMI I SHQIPËRISË NË LIDHJEN E KOMBEVE DHE ROLI I BRITANIKËVE



hje. Për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve kanë ndikuar dy elementë shumë të fuqishëm:

- Presidenti Wilson, i cili e mbrojtë Shqipërinë në Paris, duke e shpëtuuar nga copëtimi që i kishte rezervuar Traktati i Fshehtë i Londrës i vitit 1915;
- Lobimi i fuqishëm i anglezitet Aubrey Herbert, me delegacionin britanik të përbërë ose alternuar prej Lordit Robert Cecil, Lordi Balfour dhe historianit M. Fisher.

Kështu veprimi i parë e ndihmoi të dytin. Shqipëria paraqiti kërkesën për anëtarësi në dhjetor të vitit 1920. Raportin e nënkomisionit për paraqitjen e kërkesës së Shqipërisë, e mbajti Lordi Robert Cecil, përfaqësues i Mbretërisë së Bashkuar, mik i afërt i Aubrey Herbert-it. Ai në argumentet e veta rreth Shqipërisë tha se, ndonëse kufijtë e Shqipërisë ende nuk janë përcaktuar përfundimisht, fakti që vendi ekziston prej disa vitesh brenda këtyre kufijve, e vërteton ekzistencën e tij si shtet. Ndonjë rregullim i mëtejshëm mund t'i lihej së ardhmes. Lordi Cecil tha se Shqipëria duhej pranuar pasi:

"Ajo prej virtytit përbënte një komb me dëshirë të njëzëshëm të banorëve të vet." [2]

Ajo çfarë Lordi Robert Cecil kërkoi në Asamblesë e Lidhjes së Kombeve nuk gjeti përkrahje për shkak të lakmive të fqinjëve dhe shteteve që i mbështesnin ata. Megjithatë, ai lëshoi një apel të fuqishëm për anëtarësimin e Shqipërisë, i cili pati një efekt të jashtëzakonshëm. Në fjalën e tij ai deklaroi:

"Njohja fillimisht e sjell shtetin e ri në familjen e kombeve e më pas, ai vazhdon të ekzistojë që mos të zhduket prej ndonjë pushtimi apo ndonjë marrëveshjeje të përgjithshme të atyre që e lakmojnë atë; Qeveritë herë pas here ose i arrijnë qëllimet, ose dështojnë t'i arrijnë, por kur ekziston shteti si shtet, ai mbetet." [3]

Falë kësaj këmbënguljeje të Lordit Robert Cecil në Komisionin e Pestë të Asamblesë u deklarua si më poshtë:

"Në tërësi ne jemi të mendimit se megjithëse Qeveria e Shqipërisë nuk është tërësisht në pozitën që i takon, prapëseprapë ajo është një qeveri e cila ka një shkallë të caktuar autoriteti në të gjitha pjesët e vendit dhe padyshim përfaqëson një ndjenjë shumë të fortë kombëtare, e cila shpërfill dallimet fetare. Duket gjithashtu se vendi është i banuar prej një race të pastër shqiptare që flet një gjuhë të përbashkët, atë shqipe."

Argumentet e Lordit Cecil, si dhe puna e delegacionit shqiptar dhe veçanërisht paraqitja e çështjes shqiptare nga Fan Noli, bënë që Shqipëria të pranohet në Lidhjen e Kombeve më datën 17 dhjetor 1920. Ai në mënyrë të veçantë theksoi faktin se:

"Kufijtë e Shqipërisë ishin po ata të caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve dhe ajo konferencë nuk ishte abroguar. Ai theksoi faktin se shqiptarët ishin në zotërim të tërë teritorëve, përveç një zone në Korçën e liru nga francezët dhe pushtuar nga grekët.[4]

Në ndihmë të Shqipërisë nga delegacioni britanik doli edhe Mr. H. A. L. Fisher, i cili mbështeti fort ruajtjen e integritetit të Shqipërisë dhe gjeti argumente shumë të forta ligjore ndërkombëtare, se përse Lidhja e Kombeve dhe Konferenca e Ambasadorëve, si dy trupa ndërkombëtarë nuk duhet të ndërthureshin në veprimtarinë e tyre në çështjet e kufijve të Shqipërisë, siç kërkoi fqinjët lakmitarë të vendit tonë. Ai deklaroi tekstualisht:

"Këshilli i Lidhjes së Kombeve e vlerëson si të pakëshillueshëm që të merret njëherësh me të njëjtën çështje". [5]

Ai shtoi se marrëveshja midis shteteve anëtare e përjashtonte ipso facto marrjen me çështjen e kufijve të Shqipërisë nga ana e Lidhjes së Kombeve. [6]

Më 4 korrik 1921, Kryeministri shqiptar Vriani, paraqiti në Asamblesë e Lidhjes një apel ku i kërkonte Lidhjes të mos njihte asnjë shmangie nga kufijtë e caktuar prej Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913. Më datën

2 shtator 1921, u miratua një raport i përgatitur prej Lordit Balfour, ish Sekretar i Jashtëm i Britanisë dhe një ndër arkitektët e Lidhjes së Kombeve. Ai i doli zot Shqipërisë, duke e përmbledhur në tri fraza të përgjithshme tërë thelbin e kësaj çështjeje. Andaj ai udhëzoi:

- Asamblesë t'i kërkohej nga Shqipëria që të vepronte për përcaktimin e kufijve, ndërsa Këshilli të ndalonte dhunimin e tyre;
- Çështja e statusit të Shqipërisë të zgjidhej përfundimisht me pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve;
- Trajtimi i pakicave rridhte jo nga Traktati i Paqes, por nga Rezoluta e Asamblesë së Lidhjes.

Këto ide të Lordit Balfour u pranuan dhe kjo pati një ndikim shumë të madh në mbarëvajtjen e punëve të mëpastajme të Shqipërisë.

Me 4 tetor, në komisionin e gjashtë të Lidhjes, u paraqit një rezolutë nga prej Lordit nga Afrika e Jugut, Robert Cecil për kufijtë, e cila pas shumë debatesh, pas kuintave, kaloi e plotë duke i bërë një shërbim tjetër të madh çështjes shqiptare.

Një kombinim i britanikëve Balfour – Fisher – Cecil nën ndikimin e kolonelit Aubrey Herbert, në Lidhjen e Kombeve, zgjidhi shumë probleme që nxirrnin herë grekët, herë jugosllavët, e herë italianët në forma të ndryshme, sa për pretendime territoriale, ashtu edhe për trajtim të pakicave. Kështu u ra dakord për dhënien e shtetësisë çdo banori të Shqipërisë që kishte mbi dy vjet që jetonte aty pa dallim feje apo etnie. Po kështu lejohej përdorimi i çfarëdolloj gjuhe, por shqipja do të ishte gjuha zyrtare. Gjuha amtare sigurohej të përdorej në gjykata dhe fëmijët e minoriteteve të mësonin gjuhën e nënës së tyre.

Shqetësimet në kufi me Jugosllavinë bënë që kabineti qeveritar britanik t'i kushtonte rëndësi të madhe çështjes së Shqipërisë. Është kjo arsyeja pse britanikët shpallën njohjen e Shqipërisë si qeveri de jure e të gjithë shqiptarëve.[7] Këtë akt e pasuan edhe fuqitë nënshkruese të Konferencës së Ambasadorëve: Franca, Italia, Japonia, duke e njohur qeverinë e Tiranës si një shtet konstitucional të pavarur dhe sovran.[8]

Por siç dihet, telasht me fqinjët Shqipërisë nuk iu ndanë asnjëherë. Është përsëri Lordi Balfour, i cili më datën 12 mars të vitit 1922, paraqet në prani të përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre të Komisionit të Lidhjes raportin e mbikëqyrjes së kufijve, në të cilin thotë se:

"...komisioni edhe pse ka vënë re se ka një pakicë greke, (në Korçë) prapëseprapë, vëren se "qyteti është substancialisht i banuar nga shqiptarët dhe është pjesë e tokës shqiptare." [9] Anëtarësimi i Shqipërisë mban padyshim vulën e përpjekjeve të patri-

otëve shqiptarë, por si në çdo moment tjetër të zgjidhjes së çështjeve të mëdha të kombit tonë në shekullin e njëzetë, britanikët gjenden aty. Se si vajti puna me Lidhjen e Kombeve dhe ecurinë e shtetit shqiptar është një temë shumë e gjerë, por nuk mund të lihet mënjanë për asnjë çast kontributi i jashtëzakonshëm i britanikëve dhe pikërisht: Aubrey Herbert, themelues i Komitetit të Mbrojtjes së Shqipërisë, Edith Durham, Lordit Robert Cecil, Lordit Balfour dhe delegatit britanik H.A.L. Fisher.

Përfundimi i Lidhjes së Kombeve

Lidhja e Kombeve funksionoi deri në vitin 1945, kur vendin e saj e zuri Organizata e Kombeve të Bashkuara e themeluar në Konferencën e San Franciskos më datën 24 tetor 1945. Kjo është edhe data kur festohet themelimi i OKB-së. Shqipëria nuk u ftua të merret pjesë në atë konferencë. Megjithatë, "Vatra" si përherë iu gjet atdheut në krahë dhe dërgoi amerikanin Charles Telford Erickson, i cili gjatë gjithë jetës së tij aq aktive pro-shqiptare, e "bombardoi" me letra Presidentin Truman për të drejtën e Shqipërisë që të ishte pjesë e kombeve të qytetëruara. [10] Shqipëria, u pranua vetëm më datën 14 dhjetor 1955 si anëtare e Kombeve të Bashkuara. Sot objektivi kryesor i diplomacisë shqiptare dhe i tërë shtetit shqiptar është anëtarësimi i shtetit tjetër shqiptar, Republikës së Kosovës në këtë organizatë.

[1] *The Hague Confederation of States*

[2] *Proces – verbal nga mbledhja e Komitetit të Asamblesë së Parë të Lidhjes së Kombeve, nr 13, datë 11 dhjetor 1920, faqe 12-13.*

[3] *Lidhja e Kombeve: Protokoll i mbledhjes së Asamblesë së Parë, mbledhja plenare, faqe 669. Po aty, deklarata e përfaqësuesit italian: "Në momentin e tashmë qeveria italiane nuk e ka njohur qeverinë shqiptare as de jure as de facto" faqe 570.*

[4] *Lidhja e Kombeve, Proces – verbal e sesionit të trembëdhjetë të Këshillit, 17 – 28 qershor, 1921, faqe 210.*

[5] *Lidhja e Kombeve, Shënime nga sesioni i trembëdhjetë të Këshillit, 17 – 18 qershor 1921, faqe 48*

[6] *Po aty, f 48-49.*

[7] *Debate Parlamentare, House of Commons, (1921) CXIVIII, 29 Le Temp, 6,9,10 November: Woods Contemporary Review CXXI, 46.*

[8] *Lidhja e Kombeve, Official Journal, December 1921 nr 12, faqe 1195.*

[9] *Raport suplementar i 12 majit 1922 Official Journal of the League of Nations nr 5 third part 580-82.*

[10] *Archive of Yale University Divinity School Library, New England, Erickson collection group 26, series nr 5, box nr 6, folder nr 5.*

31 DECEMBER 2023

FESTA SHQIPTARE LONDON PRESENTS



YLL LIMANI - YLLKA KUQI - MAYA - GEZIM NIKA

INFO: 07512805712

ADDRESS: KERVAN BANQUETING SUITE, EDMONTON, LONDON

N9 0PD

Mos bini në kurthin e të ndenjurit gjithë ditën pa ngrënë me idenë se do hani në darkë, pasi në këtë mënyrë do të dalë jashtë kontrollit sasia e ushqimit gjatë darkës festive. Është mirë të mos shkoni në tryezën e Vitit të Ri të uritur.

Ajo jep këshilla për çdo detaj duke filluar nga pjatat mesore, sallatat, pijet dhe aq më tepër për gjelin e detit, specialiteti që nuk mungon kurrë në tryezat e shqiptarëve në darkën e Vitit të Ri.

Dhe rekomandimet e dietologes për një darkë sa më perfekte e nisin pikërisht me pijet ato që nuk duhet të mungojnë në tryezë. "Jo pije me gaz, me përjashtim të ujit të gazuar, pasi shtojnë kalori të cilat nuk ngopin.

Të konsumohet ujë pas çdo vakti gjatë ditës së festave dhe ky të shoqërojë çdo pije alkoolike që do të preferoni", - pohon dietologja e cila nuk lë pa përmendur verën e mirë për të cilën thotë se është një pije e preferuar dhe e shëndetshme.

Nuk jam kundër rakisë dhe whisky-t, nëse konsumohen me masë dhe shoqërohen vazhdimisht me ujë dhe me ushqim. Kombinimi i alkoolit me mjaltë sipas saj ndihmon në metabolizmin e alkoolit.

Ndërsa sa i përket gjelit të detit dietologja ka dhënë shpjegime të mirë organizuara se si duhet ta gatujmë për 8 persona. Mbushja e gjelit me shumë llojshmëri përbërësish, si të gatujmë lëngun e mishit dhe shumë detaje të tjera. Konkretisht recetat.

MESORE:

Sallatë ruse me fasule, bizele, karota etj dhe majonezë shtëpie
Salcë kosi të bërë vetë me pak majdanos, kas-travec, vaj ulliri dhe hudhër

Perime të zgarës: specatë kuq, kunguj, qepë, domate dhe pak gjizë pa yndyrë
Byrek me presh dhe gjizë

Sallatat:

Jeshile, rukola, spinaq të freskët me djathë dhie, fara lule dielli Lakër e bardhë, karrote, stafidhe, vaj, limon
Lakër e kuqe, e marinuar dhe molle jeshile
Pjata kryesore, gjel deti

Pjata kryesore Gjel deti:
Receta: gjel deti i mbushur
Ingredientët për 8 persona:
6-7kg gjel deti
Mbushja:
1 ½ kupë oriz
1 qepë të grirë
3/4 kupë selino të prerë

2 kupa kërpudha të freskëta në feta të holla

1 mollë jeshile në feta

4 hudhra të grira
½ kupë arra
6 kajsi të thara të prera në 4sh



½ kupë stafidhe
½ kupë majdanos i freskët
½ kupë + 1 lugë të madhe brodo pule kripe, piper
Lëngu i mishit:
6 kupa brodo pule
2 karota të mëdha në copëza
2 qepë prerë trashë
2 kërcj seleri
qafa, krahët e gjelit
1/3 kupë miell i përzier me ujë
1 lugë të madhe rozmarinë të freskët të prerë
2 lugë të vogla timio (thimari)
kripë, piper

Përgatitja e mbushjes

Zieni 3½ kupa ujë me kripë. Hidhni orizin, ziejeni pak dhe kullojeni. Vendoseni në një tas të madh.
Zieni 1 luge të madhe brodo me qepën dhe shtoni më pas kërpudhat dhe selinon. Gatuan për 2-3min.
Përzieri të gjithë përbërësit e tjerë dhe hidhni kripë – piperin. Gjithmonë mbusheni menjëherë përpara pjekjes.

Gjeli

Shpëlani, thani gjelin.
Ndizni furrën në 180 gradë C. Mbushni gjelin.
Lyeni gjelin me pak kripë, piper.
Vendoseni në furrë me gjoksin poshtë.
Vendosni në tepsit 1 kupë brodo.
Kontrollojeni derisa te bindeni që është pjekur. Lëngu:

Zieni të gjithë përbërësit pa miellin, timion, rozmarinen, kripën dhe piperin për rreth 1 orë në zjarr mesatar.
Kulloni ujin duke larguar copat e ngurta. Zieni ¼ kupë brodo në një tigan dhe hidhjeni nga pak miellit. Vazhdoni të hidhni pjesën tjetër të brodos pak nga pak duke e mbajtur mbi zjarr të ulët.
Shtoni rozmarinën dhe gatujeni për 20min. Spërkateni me timio (thimari), kripë dhe piper.

Ëmbëlsira, 200-300 gramë!

Ëmbëlsirat nëse konsumohen në një porcion normal (200-300gr) ofrojnë diku te 600 – 700 kalori për të cilat do duheshin rreth 2 orë vrap që të harxhohen! E vetmja gjë që mund të bëni është të kurseni disa ushqime të nesërmen!

DARKA E VITIT TË RI 10 KESHILLA REALE SI TË HANI PER QEJF DHE MOS MAJMENI...

Netët festive të ndërrimit të viteve dhe ditët e para të Vitit të Ri, përveçse argëtimit, na sjellin dhe ... shëndet. Ky vjen mes drekave dhe darkave pafund me miqtë e të afërmit, si edhe kokëçarjes së munguar të punës. Ky shëndet duket se na zbukuron gjatë këtyre ditëve, por na bën të dukemi keq nëse e teprojmë me ushqimin.

1 – Respektoni ritmin e ngrënies:

Edhe në pushime sundon regjimi tradicional: mëngjes, drekë dhe darkë. Shmangni ushqimet si ngrënie vaktesh në mes tyre.

2 - Hani çdo gjë në sasi të vogla

Gjatë festave mundohuni jo të ngopeni shumë, por të shijoni sa më shumë asortimente, çka do të thotë se duhet që të hani në sasi të vogla dhe gjëra sa më të shumëllojshme.

3 - Fruta dhe perime sa më shumë

Këto duhet të zënë shumicën e ushqimit të festave, duke siguruar për ju kështu sa më shumë fibra dhe ujë, duke shmangur dhe djegur kaloritë e tepërta që ju fryjnë.

4 - Pjata të vogla dhe të zbukuruar

Përdorni sa më shumë pjatëza të vogla, të lezetshme me gjëra që kanë shije të veçantë. Pra qëndroni larg pjatave të mbushura plot, por preferoni të voglat që ju bëjnë të shijoni në to, qoftë edhe një luleshydhe. Sepse uria nuk është çdo gjë, imazhi vlen shumë, ashtu si kuzhinierët që ngopen me aromën e asaj që gatujnë, ju mund të ngopeni me pamjen e lezeçme të një darke festive.

5 - Jo ushqime të rënda dhe me yndyrna

Mundohuni të hani sa më shumë

peshk, mish të lehtë dhe aspak mish të yndyrshëm. U thoni Jo ushqimeve të rënda gjatë periudhës së festave.

6 - Kursejini sa më shumë kaloritë

Duhet t'u rezistoni kalorive, për shembull, të mos hahet buka e as brumëra të tjera apo të shtoni krem për garniturë mbi kekun që njihet si Panettone.

7 - Shpërndajeni ushqimin si duhet

Shpërndajeni ushqimin siç duhet gjatë ditës suaj, pa u munduar të krijoni shumë vakte në një kohë të ngjeshur.

8 - Jo darkave të bollshme

Gjatë ditëve dhe netëve fesdive, u thoni Jo darkave të bollshme dhe përiquni që në këtë vakt të hani vetëm ndonjë ëmbëlsirë apo gjë të lezetshme, me një shije speciale.

9 - Mos harroni edhe të lëvizni

Edhe pse jeni më shumë në shtëpi apo ambiente të mbyllura, mos harroni që të lëvizni gjatë periudhës së festave, qoftë edhe brenda tyre. Mos rriini vetëm pasivë.

10 - Të jeni gati për rinisjen

Mos harroni të bëni një plan për janarin, lëvizjet, punën, mendime këto që duket sikur ju bezdisin kur jeni me pushime, por në fakt, ua mbajnë trurin të freskët dhe të ingranuar, larg një pushimi total që mund t'ju bënte më shumë keq se mirë.

HILAL FOOD CENTRE URON TE GJITHË KLIENTËT



& SHQIPTARËT



NË BRITANI

Te gjitha produktet e Ballkanit ne nji Market

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059

Gëzuar Vitin e Ri 2024!



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

**Mos lejoni që Viti i Ri
tu gjejë pa një website
për biznesin tuaj**

Për çdo konsultim mund te vini
në çdo kohë në zyrat tona



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road,
London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



Albcontacts

The Albanian